Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana - Ombudsperson institution
Nr./Br./No. 2412026
Nr. i fq/Br.str/Nr.pg.
Data/Datum/Date: 06/11/2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA II

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 252/2023

në lidhje me

gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës nga perspektiva e të drejtave të njeriut

"Uji i pijshëm i sigurt, higjiena dhe sanitacioni janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut"- OBSh

Drejtuar: Z. Albin Kurti, kryeministër i Republikës së Kosovës

Znj. Fitore Pacolli Dalipi, ministre e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Z. Elbert Krasniqi, ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Për dijeni: Znj. Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Z. Arsim Ademi, kryetar i Komisionit për Mjedis, Planifikim Hapësinor, Ushqim, Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Transport i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Z. Habit Hajredini, drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 6 nëntor 2026

Qëllimi i Raportit

Ky raport ka për qëllim të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut, duke vlerësuar kornizën ligjore dhe institucionale që rregullon menaxhimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e resurseve ujore, si dhe nivelin e zbatueshmërisë së saj në praktikë. Raporti synon të identifikojë boshllëqet dhe sfidat që pengojnë menaxhimin dhe mbrojtjen efektive të resurseve ujore, si dhe realizimin e së drejtës për qasje në ujë të sigurt dhe sanitacion, si dhe të së drejtës për të jetuar në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, duke u mbështetur në standardet kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Raporti është iniciuar mbi bazën e raportimeve institucionale dhe raportimeve mediale, lidhur me gjendjen dhe cilësinë e ujërave në vend. Nëpërmjet raportit, Avokati i Popullit ofron një pasqyrim të gjendjes së resurseve ujore në vend, duke trajtuar, ndër të tjera, ndotjen dhe degradimin e lumenjve, shkarkimin e ujërave të patrajtuara, shfrytëzimin e paqëndrueshëm të resurseve ujore, rrezikun nga përmbytjet, ndikimin e aktiviteteve dhe projekteve infrastrukturore në ekosistemet ujore, si dhe çështjet që lidhen me qasjen në ujë të sigurt dhe sanitacion. Njëkohësisht, raporti ofron rekomandime konkrete për autoritetet relevante dhe institucionet përgjegjëse, me qëllim të forcimit të mekanizmave për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave dhe avancimin e politikave publike në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor është orientimi drejt respektimit të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe shtetit të së drejtës, në funksion të mbrojtjes së resurseve ujore, garantimit të qasjes së barabartë në ujë të sigurt dhe sanitacion, mbrojtjes së shëndetit publik dhe sigurimit të një mjedisi të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *"Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike."* Ndërsa në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore."* Bazuar në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

   - *"Të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.* (neni 16, paragrafi 4)*;*

   - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2)*;*

   - *t'u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës*

së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5)*;*

- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6)*."*

E drejta e njeriut për qasje në ujë dhe sanitacion[1] dhe menaxhimi efektiv i resurseve ujore

2. Menaxhimi efektiv dhe i qëndrueshëm i resurseve ujore përbën një parakusht themelor për garantimin e furnizimit të vazhdueshëm me ujë në sasi të mjaftueshme, me cilësi të përshtatshme dhe në kohën e vendin e duhur për të përmbushur nevojat e popullsisë, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore konsiderohet një nga elementet kyçe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjen e ekosistemeve dhe sigurimin e mirëqenies së brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.

3. Menaxhimi i resurseve ujore duhet të bazohet në parimet e përdorimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore, parandalimit të ndotjes, ruajtjes së ekuilibrit ekologjik dhe planifikimit afatgjatë. Në këtë fushë, shtetet kanë përgjegjësi të zhvillojnë politika dhe mekanizma që sigurojnë shfrytëzimin racional të ujërave, mbrojtjen e tyre nga degradimi dhe garantimin e disponueshmërisë së tyre për gjeneratat e ardhshme.

4. Degradimi i burimeve ujore, ndotja e lumenjve dhe liqeneve, shfrytëzimi i pakontrolluar i ujit, ndryshimet klimatike, si dhe ndërhyrjet e paplanifikuara në ekosistemet ujore paraqesin ndër sfidat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave. Për këtë arsye, çdo aktivitet që mund të ketë ndikim në resurset ujore duhet të bazohet në vlerësime të plota të ndikimit në mjedis, në parimin e parandalimit dhe në zbatimin e masave që minimizojnë dëmet ndaj ekosistemeve ujore.

5. Zhvillimi i projekteve infrastrukturore që ndikojnë në burimet ujore, përfshirë hidrocentralet, digat, sistemet e ujitjes dhe aktivitetet e tjera ekonomike, duhet të realizohet në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, legjislacionin mjedisor dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto procese duhet të përcillen me transparencë, pjesëmarrje efektive të publikut në vendimmarrje, qasje në informata dhe qasje në mjete juridike efektive, në përputhje me standardet e Konventës së Aarhus-it. Po ashtu, aktivitetet që ndikojnë në shtratin dhe rrjedhën natyrore të lumenjve, përfshirë nxjerrjen e inerteve, duhet t'i nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes efektive nga autoritetet kompetente, me qëllim të parandalimit të degradimit të ekosistemeve ujore, ruajtjes së biodiversitetit dhe zvogëlimit të rrezikut nga përmbytjet, erozioni dhe pasojat e tjera mjedisore.

6. Qasja në ujë të sigurt dhe sanitacion[2] është një nga parakushtet themelore për realizimin e dinjitetit njerëzor, mbrojtjen e shëndetit publik dhe gëzimin efektiv të të drejtave të tjera të njeriut. Ajo konsiderohet një element thelbësor për luftimin e varfërisë, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht parimit që askush të mos mbetet pas (leave no one behind). Me Rezolutën 64/292 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të miratuar në vitin 2010, u njoh se

[1] Sigurimi i kushteve higjienike përmes largimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit.

[2] Sanitacion: tërësia e masave dhe sistemeve që shërbejnë për grumbullimin, largimin, trajtimin dhe menaxhimin e ujërave të ndotura**,** me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

e drejta për ujë të pijshëm të sigurt dhe sanitacion është një e drejtë themelore e njeriut, e domosdoshme për gëzimin e plotë të së drejtës për jetë dhe të të drejtave të tjera të njeriut.

7. E drejta për ujë dhe sanitacion mbështetet në disa elemente thelbësore, të zhvilluara nga instrumentet dhe mekanizmat ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut. Këto përfshijnë disponueshmërinë e ujit në sasi të mjaftueshme, qasjen fizike në shërbime, cilësinë dhe sigurinë e ujit, pranueshmërinë e shërbimeve, si dhe përballueshmërinë ekonomike të tyre. Po aq të rëndësishme janë parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë, të cilat kërkojnë që të gjithë personat të kenë qasje në këto shërbime pa asnjë formë diskriminimi, me vëmendje të veçantë ndaj personave dhe grupeve në situata të cenueshme.

8. Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ua imponojnë shteteve detyrimin që, nëpërmjet masave legjislative, administrative dhe financiare, të ndërmarrin hapa progresivë për sigurimin e qasjes universale në ujë dhe sanitacion. Në këtë kuadër, shtetet duhet të garantojnë që shërbimet të jenë financiarisht të përballueshme për të gjithë, pa cenuar realizimin e të drejtave të tjera themelore. Edhe pse e drejta për ujë dhe sanitacion nuk nënkupton domosdoshmërisht ofrimin falas të këtyre shërbimeve, shtetet kanë përgjegjësi të sigurojnë që askush të mos privohet nga qasja në sasinë minimale të ujit të nevojshëm për plotësimin e nevojave themelore për shkak të pamundësisë ekonomike.

Veprimet e Avokatit të Popullit

9. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 31 mars 2023, ka hapur hetime ex officio (me vetiniciativë) në lidhje me gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës dhe ndikimi në të drejtat e njeriut.

10. Avokati i Popullit, në vazhdimësi, përmes raporteve vjetore, ka ngritur shqetësime lidhur me cilësinë e ajrit dhe të ujërave në Republikën e Kosovës, duke vënë në pah ndikimin e ndotjes dhe degradimit të tyre në shëndetin, mirëqenien dhe të drejtat e qytetarëve. Në këtë drejtim, ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse për tejkalimin e vlerave të lejuara të ndotësve atmosferikë, ndotjen dhe degradimin e burimeve ujore, shkarkimin e ujërave të patrajtuara, si dhe mangësitë në monitorimin, mbikëqyrjen inspektuese dhe zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse. Avokati i Popullit ka ritheksuar nevojën për përmbushjen efektive të detyrimeve ligjore dhe ndërmarrjen e masave konkrete e të qëndrueshme nga institucionet kompetente, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik dhe garantimit të të drejtave të njeriut.[3]

11. Më 3 maj 2024, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh kompetencat e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) lidhur me gjendjen e ujërave, i është drejtuar me shkresë ministrit të MMPHI-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata për veprimet që i ka ndërmarrë dhe për ato që planifikon t'i ndërmarrë në lidhje çështjet e renditura në vijim:

    1) A janë ndërmarrë veprime për hartimin e planit për menaxhimin e rrezikut preliminar nga vërshimet?

    2) A janë ndërmarrë veprimet apo planifikohen të ndërmerren, në lidhje me sigurinë e ujit që furnizohet nga sistemet e ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të, dhe si pasojë nuk i nënshtrohen kurrfarë kontrolli dhe mbikëqyrjeje nga institucionet

[3] https://oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore/

relevante, si dhe nuk zbatohen masa mbrojtëse për burimet e ujit nga të cilat furnizohen këto sisteme?

3) Në cilën fazë ndodhet procedura e hartimit të ligjit të ri për menaxhimin e resurseve ujore?

4) Duke qenë se funksionimi efektiv inspektimeve është kyç për zbatimin dispozitave ligjore për menaxhimin e resurseve ujore, a është paraparë fuqizimi i kapaciteteve dhe rritja e numrit të inspektorëve në MMPHI?

5) Duke marrë parasysh se, sipas informatave të marra nga koncept-dokumenti i MMPHI-së, i miratuar me vendim nga kryeministri më 26 korrik 2023, në të cilin, përveç të tjerash, konstatohet: "*Në Kosovë, problemet në menaxhimin e resurseve ujore janë të shumta dhe përfshijnë praktikisht të gjitha aspektet e këtij sektori. Problemi kyç qëndron në strukturën institucionale të pa definuar qartë dhe të pa konsoliduar. Për pasojë, shkalla e implementimit të objektivave nga dokumentet e politikave dhe dokumentet strategjike është jashtëzakonisht e ulët.*", na njoftoni se a ka filluar MMPHI-ja të ndërmarrë veprime për përmirësimin e strukturës institucionale.

6) A është zhvilluar plani për parandalimin dhe mbrojtjen e lumenjve nga eksploatimi i pakontrolluar i aluvioneve dhe nga ndotja prej mbeturinave?

7) Në sa komuna janë të vendosura aktualisht impiantet, a janë të tjera në proces të vendosjes dhe a është planifikuar vendosja e impianteve të reja? Ju lutemi na njoftoni për secilën pyetje veç e veç?

8) A monitorohet ndotja e ujërave nga ndotja prej shkarkimit të ujërave industriale?

9) A janë evidentuar nga ARPL-ja zonat erozive dhe a janë ndërmarrë masa dhe veprime për mbrojtjen nga erozioni?

10) A janë të mjaftueshme masat për mbrojtjen e zonave përreth burimeve ujore dhe a ka plane për rritjen e sigurisë?

11) A ka plane për përmirësimin e furnizimit me ujë në zonat urbane dhe rurale?

12) Cilat masa janë ndërmarrë dhe cilat janë planet për zvogëlimin e humbjeve të ujit nga sistemet publike të ujësjellësit?

13) A janë ndërmarrë veprimet bazuar në rekomandimet e AMMK-së:

- *Veprimet efektive të institucioneve zbatuese (Inspektoratit, Policisë, Gjykatave) në zbatimin e ligjit;*
- *Rritjen e rentave minerare; dhe*
- *Implementimin e projekteve për revitalizimin dhe kthimin në gjendjen natyrore të zonave të degraduara të lumenjve, në rastet kur kjo është e mundur.*

14) A është nxjerrë nga MMPHI-ja udhëzuesi për mënyrën e hartimit dhe shqyrtimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM)?

12. Më 25 korrik 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar ministrit të MMPHI-së me shkresë rikujtuese. Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje nga MMPHI-ja.

13. Më 3 maj 2024, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh kompetencat e Ministrisë së

Administrimit të Pushtetit Lokal, si organ mbikëqyrës i komunave për zbatimin e përgjegjësive dhe të kompetencave të tyre, dhe posaçërisht rëndësinë e mbikëqyrjes inspektuese të ujërave si masë për mbrojtjen e ujërave, i është drejtuar me shkresë ministrit të MAPL-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata mbi kapacitetet inspektuese të komunave të Republikës së Kosovës, me inspektorë të autorizuar të ujërave, siç parashikohet me ligj, apo nëse është ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të rritjes së kapaciteteve ekzistuese.

14. Më 25 korrik 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar ministrit të MAPL-së me shkresë rikujtuese. Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje nga MAPL-ja.

15. Më 3 maj 2024, Avokati i Popullit, duke marrë parasysh kompetencat e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), si institucion shtetëror për kryerjen e veprimtarisë hidrometeorologjike në lidhje me monitorimin e cilësisë së ujërave, i është drejtuar me shkresë drejtorit të IHMK-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata në lidhje çështjet e renditura në vijim:

    1) A ka IHMK-ja pajisje të mjaftueshme për monitorimin e ujërave në vend?

    2) A ka IHMK-ja kapacitete njerëzore dhe materiale të mjaftueshme për përmbushjen e kompetencave ligjore?

    3) A janë të mjaftueshme pajisjet e Rrjetit Hidrometrik të Monitorimit dhe Raportimit në Kohë Reale, të vendosura së fundmi, dhe a e mbulojnë në përgjithësi monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave?

    4) Cilët janë lumenjtë më të ndotur dhe cilët janë parametrat me më shumë tejkalime?

    5) Cilat janë presionet më të mëdha në lumenj?

    6) Bazuar në Rishikimin e Parë të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027[4], i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në qershor 2023: *"Është vlerësuar se në lidhje me cilësinë e ujit në pellgjet lumore të Kosovës, respektivisht për përcaktimin e statusit të trupave ujorë bazuar në metodologjinë që zbatohet sipas direktivave dhe legjislacionit vendor, mungojnë matjet e plota dhe nuk zbatohet monitorimi biologjik i ujërave."* Ju lutemi, na informoni për arsyet e këtyre matjeve të mangëta dhe pse nuk zbatohet monitorimi biologjik i ujërave.

    7) Në lidhje me përcaktimin e cilësimit të ujërave në bazë të analizave fiziko-kimike dhe të metaleve të rënda, sa pika të monitorimit (stacione monitoruese) i ka rrjeti i monitorimit, a konsiderohen të mjaftueshme dhe sa herë në vit kryhen matjet?

    8) Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet IHMK-ja, përfshirë gjendjen e kapaciteteve njerëzore dhe ato materiale, për zbatimin e kompetencave?

16. Më 25 korrik 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar drejtorit të IHMK-së me shkresë rikujtuese.

17. Më 8 gusht 2024, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga drejtori i IHMK-së, përkatësisht nga Sektori për Monitorimin e Cilësisë se Ujerave, dhe nga Sektori i Hidrologjisë, si vijon:

4 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78647

"Sektori për Monitorimin e Cilësisë së Ujërave, i cili vepron në kuadër të IHMK-së, disponon një gamë të gjerë pajisjesh për përcaktimin e parametrave fiziko-kimikë, të cilat mundësojnë vlerësimin bazik të cilësisë së ujërave që IHMK-ja është e detyruar t'i monitorojë. Këto përfshijnë ujërat sipërfaqësore, lumenjtë, liqenet dhe ujërat nëntokësore. Laboratorët e IHMK-së kanë nevojë të vazhdueshme për pajisje të reja për shkak të vjetërsimit dhe defekteve që shfaqin ato ekzistuese. Në këtë drejtim, janë realizuar investime të ndryshme, si nga buxheti qeveritar, ashtu edhe nga donatorë të ndryshëm.

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, mungesa e stafit është një çështje që diskutohet prej 23 vitesh. Para 21 vitesh, numri i stafit ishte rritur në 24 persona, por me kalimin e kohës ky numër është zvogëluar në 11, sa është aktualisht. Në procedurë janë konkurset për 6 vende pune ekzistuese, disa prej të cilave nuk janë plotësuar për katër vitet e fundit, për shkak të vendimeve të qeverive në pushtet që kanë ndaluar shpalljen e konkurseve për pranimin e stafit të ri. Për krahasim, institucionet e ngjashme në vendet fqinje kanë kapacitete shumë më të mëdha: Maqedonia ka staf prej 190 personash, Mali i Zi 195, ndërsa Kroacia 330.

Sa i përket materialeve për realizimin e monitorimit të cilësisë së ujërave, konsiderojmë se ato janë të kënaqshme.

Kapacitetet e rrjetit hidrometrik për monitorimin bazë të sasisë së ujërave në lumenjtë e Kosovës janë pothuajse të mjaftueshme, kjo falë projektit FLLOWS të Bankës Botërore të realizuar vitin e kaluar. Megjithatë, mungon një rrjet i mirëfilltë për monitorimin e ujërave nëntokësore në nivel vendi. Në tri pellgjet lumore - Ibër, Lepenc dhe Morava e Binçës - rrjeti ekzistues nuk është i mjaftueshëm, dhe shpërndarja e stacioneve nuk është në përputhje me kërkesat për monitorim efektiv të ujërave nëntokësore. Kjo nënkupton nevojën për shtimin e stacioneve për të siguruar një monitorim të plotë dhe të qëndrueshëm të këtyre resurseve.

Bazuar në analizat fiziko-kimike, lumenjtë më të ndotur renditen si më poshtë: Graçanka në Vragoli, Sitnica përgjatë gjithë rrjedhës, Nerodime në Gerlicë dhe Kacanik, Drenica në Drenas dhe Vragoli, Limani i Klinës në Klinë, etj. Sipas UA 17/2017 të MMPH-së për klasifikimin e trupave ujore sipërfaqësore, tabela 4.1 në shtojcën 4 përcakton vlerat orientuese të elementeve fiziko-kimikë të cilësisë së lumenjve. Monitorimet tona gjatë viteve kanë konstatuar se parametrat që tejkalojnë këto vlera orientuese kryesisht janë: shpenzimi kimik i oksigjenit, shpenzimi biokimik i oksigjenit, nitratet, fosfatet, nitritet dhe amoniaku.

Presionet më të mëdha në ndotjen e lumenjve janë shkarkimet urbane të ujërave të patrajtuara, aktivitetet industriale, përdorimi bujqësor, hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve, dhe degradimi hidromorfologjik i lumenjve.

Monitorimi biologjik është një aktivitet që nuk është arritur të implementohet ende në mënyrë sistematike, pasi sipas Direktivës Kornizë të Ujërave 60/2000/EC, ky monitorim duhet të kryhet një herë në tre vjet. Ky monitorim është parashikuar të realizohet përmes projekteve me angazhim të stafit akademik nga Universiteti i Prishtinës ose konsulentëve ndërkombëtarë. Një monitorim i tillë u realizua në pellgun e Drinit të Bardhë në vitin 2009 përmes fondeve të BE-së, me përfshirjen e konsulentëve ndërkombëtarë dhe vendorë. Gjithashtu, gjatë periudhës prill 2023 - mars 2024, Projekti "Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë", i

financuar nga SDC Zvicerane dhe implementuar nga SKAT, ka realizuar monitorim biologjik të ujërave sipërfaqësore në pellgjet e Ibër, Lepenc dhe Morava e Bënçës.

Rrjeti i monitorimit për ujërat sipërfaqësore përbëhet nga 56 pika monitorimi, përfshirë 22 burime lumenjsh që konsiderohen si pika referente dhe që nuk janë të ndikuara nga ndotjet. Këto monitorohen dy herë në vit, në mars dhe gusht. Ndërkohë, 34 pika të tjera monitorohen për ndotje të vazhdueshme dhe matjet kryhen 12 herë në vit. Bazuar në kërkesat ligjore, ky rrjet dhe frekuenca e monitorimit konsiderohen të mjaftueshme.

IHMK ballafaqohet me mungesë të hapësirave laboratorike për sektorët përkatës, mungesë të stafit dhe nevojë për ngritje profesionale dhe trajnime të vazhdueshme."

18. Duke marrë parasysh kompetencat e IKShPK-së për monitorimin e cilësisë së ujit, si dhe duke u bazuar në raportin vjetor të IKShPK-së për vitin 2024, në të cilin është raportuar se "*Janë analizuar 4,586 mostra te ujit ne laboratorë të ndryshëm te QLT -se*", më 10 shtator 2025, përfaqësuesja e IAP-së i është drejtuar IKShPK-së me kërkesë për informata për ofrimin e rezultateve të monitorimit përkatës për vitet 2024 dhe 2025.

19. Më 29 shtator 2025, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigjen nga IKShPK-ja, si në vijim: *"Konform përgjegjësive të IKSHPK-së sipas UA nr. 10/2021, Divizioni i Ujit në DEH përcjellë cilësinë e përgjithshme të ujit të trajtuar, gjegjësisht ujit nga rubineti që u ofrohet konsumatorëve në 58 zona të furnizimit (ZF), të shtrira në zonat e shërbimit të 7 KRU-ve. Monitorimi i ujit realizohet sipas Planit të Monitorimit, i cili është hartuar në përputhje me UA nr. 10/2021 "Për cilësinë e ujit për konsum njerëzor", ku përcaktohet frekuenca e marrjes së mostrave dhe analizimit të cilësisë së ujit, në raport me sasinë mesatare ditore të ujit që futet në një zonë furnizimi si dhe me numrin ekuivalent të banorëve.*

Rezultatet e vitit 2024

- *Gjatë vitit 2024, Qendra e Ujit në IKSHPK ka analizuar gjithsej 11,016 mostra, prej të cilave 98.7% kanë qenë në përputhshmëri me vlerat parametrike të UA nr. 10/2021.*
- *Analizat bakteriologjike: Nga gjithsej 7,291 mostra, 144 (1.97%) kanë rezultuar jashtë standardeve, me një përputhshmëri prej 98.03%.*
- *Parametrat kimikë: Nga gjithsej 3,499 mostra të testuara, 96 mostra (2.74%) nuk kanë përmbushur standardet. Përputhshmëria në nivel të Kosovës për muajin korrik ka qenë 97.2%.*
- *Metalët e rëndë: Janë analizuar gjithsej 226 mostra dhe të gjitha kanë qenë brenda standardeve të parapara në UA nr. 10/2021.*

Rezultatet e vitit 2025 (Janar - Gusht)

- *Në këtë periudhë janë analizuar gjithsej 8,435 mostra, prej të cilave 98.2% kanë qenë në përputhshmëri me vlerat parametrike të UA nr. 10/2021.*
- *Analizat bakteriologjike: Nga 5255 mostra të testuara, 80 (1.5%) kanë rezultuar jashtë standardeve, duke dhënë një përputhshmëri prej 98.5%.*
- *Parametrat kimikë: Nga gjithsej 3034 mostra të testuara, 74 (2.43%) kanë rezultuar jashtë standardeve. Përputhshmëria në muajin korrik ka qenë 97.6%.*

Fenomeni i manganit në Liqenin e Badocit

- *Gjatë vitit 2024 është riparaqitur fenomeni i manganit (Mn2+) në Liqenin e Badocit, si dukuri e vazhdueshme që ndodh kryesisht gjatë ndërrimit të stinëve.*
- *Nga Impianti i Trajtimit të Ujit në Badoc furnizohen banorët e zonës së furnizimit PR03 (Prishtinë, Hajvali, Çagllavicë dhe Graçanicë).*
- *Sipas UA nr. 10/2021, norma e lejuar për mangan në ujin e pijshëm është 0.05 mg/L*
- *Në vitin 2024 ky fenomen ka qenë më i theksuar, pasi përveç rritjes së vlerave të manganit, është shoqëruar edhe me kohëzgjatje më të madhe: ka filluar në gjysmën e dytë të shtatorit dhe ka vazhduar deri në gjysmën e parë të nëntorit.*
- *Në vitin 2025, në fund të muajit gusht, vlerat e manganit ishin në trend rritës dhe gjatë 2 javeve te para te muajit shtator kanë tejkaluar standardin shëndetësor sipas OBSH-së prej 0.3 mg/L.*
- *Gjatë javës së kaluar, (15.09 - 21.09.2025) bazuar në matjet e kryera në laboratorët e IKSHPK-së, mostrat e ujit të marra nga rrjeti shpërndarës në zonën e furnizimit PR03-Badoc, kanë rezultuar me ulje të ndjeshme të vlerave të manganit.*

IKSHPK rekomandon që KRU "Prishtina" të vazhdojë mbikëqyrjen në të gjitha fazat e trajtimit të ujit, si dhe të ndërmarrë masa të rregullta për shpëlarjen e rrjetit shpërndarës, duke përfshirë gypat magjistralë dhe sekondarë. Kjo do të sigurojë furnizim me ujë në sasi dhe cilësi të plotë, sipas standardeve për ujin e pijshëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IKSHPK si misioni i tij kryesor ka mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës, nëpërmjet aktiviteteve profesionale dhe në përputhje me ligjet aktuale, të harmonizuara me legjislacionin evropian."

20. Më 29 shtator 2025, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet adresës elektronike, i është drejtuar IHMK-së me kërkesë për përditësimin e informatave sipas përgjigjes së datës 8 gusht 2024. Më 1 tetor 2025, IHMK-ja i ka kthyer përgjigje IAP-së, nëpërmjet së cilës IAP-ja është informuar se, në krahasim me informatat e dhëna nga IHMK-ja më 8 gusht 2024, përgjigjja e datës 1 tetor 2025 nuk paraqet ndryshime substanciale lidhur me gjendjen e monitorimit të cilësisë së ujërave, kapacitetet laboratorike, rrjetin monitorues, identifikimin e lumenjve më të ndotur, parametrat kryesorë të ndotjes, burimet e ndotjes apo sfidat institucionale. Këto vlerësime mbeten të njëjta si në përgjigjen e vitit 2024. Megjithatë, IHMK-ja ka njoftuar për disa zhvillime dhe përditësime të reja, si vijon:

    i) Përmirësim i kufizuar i kapaciteteve njerëzore. Ndryshe nga përgjigjja e vitit 2024, kur kishte njoftuar se në procedurë ishin konkurset për gjashtë vende pune ekzistuese, IHMK-ja ka bërë të ditur se gjatë vitit 2025 është pranuar një zyrtar laboratori në sektorin e cilësisë së ujërave, ndërsa në procedurë kanë mbetur edhe pesë vende pune për t'u plotësuar.

    ii) Zgjerimi i monitorimit biologjik dhe të substancave prioritare. Përveç monitorimit biologjik të realizuar gjatë periudhës 2023-2024 në pellgjet e Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës, IHMK-ja ka njoftuar se gjatë periudhës 2024-2025 është realizuar monitorimi biologjik edhe në pellgun e Drinit të Bardhë. Gjithashtu, për herë të parë është raportuar se në kuadër të këtij projekti është realizuar edhe monitorimi i substancave prioritare organike (PAH dhe pesticideve), krahas monitorimit të parametrave fiziko-kimikë. Sipas IHMK-së, këto aktivitete janë realizuar në kuadër të projektit "Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë", të implementuar nga SKAT dhe të financuar nga SDC – Qeveria Zvicerane.

21. Më 30 korrik 2026, përfaqësueset e IAP-së realizuan takim zyrtar me drejtorin e Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL), me qëllim të marrjes së informatave shtese në lidhje me gjendjen e ujërave në vend dhe për veprimet e ndërmarra. Në kuadër të këtij takimi, përfaqësuesit e ARPL-së informuan si vijon:

    - *"Ende nuk është realizuar ndonjë vlerësim në lidhje me zbatimin Rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027, por janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme, disa janë përfunduar dhe disa janë në proces. Janë ndërtuar 5 impiante, 3 prej tyre janë funksionale, ndërsa impiantet në proces ndërtimi janë në Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë. Sipas vlerësimit të nevojave për të gjitha vendbanimet me mbi 2000 banorë, duhet të ndërtohen impiante për trajtim të ujërave të ndotura. Trajtimi i ujërave të ndotura është edhe përgjegjësi e komunave, ku secila komunë duhet ta bëjë planin e fizibilitetit për fshatrat për nevojën e ndërtimit të impianteve.*
    - *Është finalizuar plani i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet.*
    - *Planin për zhvillimin urbanistik të komunave, komunat duhet ta zhvillojnë në përputhje me Planifikimin hapësinor të nivelit qendror.*
    - *Në shumicën e komunave nuk ka zyrtar mjedisor dhe inspektor mjedisor. Edhe pse u është rekomanduar nga niveli qendror (MMPHI/ARPL) komunat nuk kanë ndërmarr veprime për planifikimin dhe plotësimin e pozitave përkatëse. Dhe po ashtu shumica e komunave nuk kanë plan lokal për mbrojtjen e mjedisit."*

Për sa u përket sfidave me të cilat përballet ARPL-ja për zbatimin efektiv të përgjegjësive, u theksua:

- *"Do të duhej të rregullohet ligjërisht bashkëpunimi i MMPH me MBPZHR, pasi kjo e fundit ka ndikim tek ujërat sa i përket shfrytëzimit të ujit për ujitjen e tokave bujqësore, të cilat i realizojnë pa u pajisur me leje nga MMHP.*
- *Sfida të vazhdueshme sa i përket bashkëpunimit efektiv me komunat lidhur me mjedisin dhe ujërat. Ka mungesë të kapaciteteve profesionale nëpër komuna lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe ka mungesë të resurseve njerëzore. Ka mosinteresim për t'i zbatuar efektivisht thirrjet, këshillat dhe rekomandimet e ministrisë për zhvillimin e planeve për mbrojtjen e mjedisit."*

Baza ligjore

E Drejta Ndërkombëtare për Ujëra

22. E Drejta Ndërkombëtare për Ujërat përbën sistemin e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve lidhur me përdorimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore ndërkufitare. Duke pasur parasysh se rreth 60% e ujërave rrjedhëse në nivel global janë ndërkufitare, bashkëpunimi ndërkombëtar konsiderohet thelbësor për sigurimin e një menaxhimi të qëndrueshëm, të drejtë dhe efektiv të tyre. Korniza e së drejtës ndërkombëtare për ujërat përfshin:

    - Të drejtën zakonore ndërkombëtare;
    - Konventat ndërkombëtare globale dhe rajonale, përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për Përdorimin e Ujërrjedhave Ndërkombëtare për Qëllime Jo-Lundruese (1997) dhe Konventën e UNECE-së për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërrjedhave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (1992);

- Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale ndërmjet shteteve; dhe
- Praktikën gjyqësore ndërkombëtare, përfshirë vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

23. Parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare për ujërat synojnë të sigurojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe të parandalojnë konfliktet ndërmjet shteteve që ndajnë të njëjtat pellgje ujore. Këto parime përfshijnë:

- Parimi i shfrytëzimit të drejtë dhe të arsyeshëm, sipas të cilit çdo shtet ka të drejtë të shfrytëzojë burimet ujore që ndodhen në territorin e tij, në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme, duke marrë parasysh interesat legjitime të shteteve të tjera ripariane. Ky parim nuk nënkupton ndarje të barabartë të burimeve ujore, por një përdorim të drejtë dhe proporcional.
- Parimi i mosshkaktimit të dëmit të konsiderueshëm, sipas të cilit asnjë shtet nuk duhet t'i shfrytëzojë ujërrjedhat ndërkufitare në mënyrë që t'u shkaktojë dëme të konsiderueshme shteteve të tjera të pellgut ose mjedisit.
- Parimi i njoftimit, konsultimit dhe negocimit paraprak, i cili kërkon që çdo shtet riparian t'i njoftojë dhe konsultojë paraprakisht shtetet e tjera të interesuara për projektet ose aktivitetet që mund të kenë ndikim në interesat dhe të drejtat e tyre, duke mundësuar zhvillimin e negociatave para ndërmarrjes së veprimeve.
- Parimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, sipas të cilit shtetet ripariane kanë detyrimin të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të shkëmbejnë informacione për gjendjen e burimeve ujore, monitorimin e tyre, si dhe për aktivitetet ekzistuese ose të planifikuara që mund të ndikojnë në to.
- Parimi i zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve, i cili obligon shtetet që çdo mosmarrëveshje lidhur me përdorimin ose menaxhimin e burimeve ujore ta zgjidhin përmes negociatave, ndërmjetësimit, arbitrazhit ose mjeteve të tjera paqësore të parashikuara nga e drejta ndërkombëtare.

Acquis i Bashkimit Evropian në fushën e ujërave

24. Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e ujërave përbëhet nga një kornizë e gjerë direktivash dhe instrumentesh ligjore (acquis communautaire), të cilat përcaktojnë standardet dhe objektivat që shtetet anëtare duhet të zbatojnë për mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, si dhe për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

25. Ndër instrumentet kryesore të Acquis-it të Bashkimit Evropian në këtë fushë përfshihen:

- Direktiva Kornizë për Ujërat (2000/60/EC), e cila vendos kornizën e përgjithshme për menaxhimin e integruar të resurseve ujore në nivel të pellgjeve lumore dhe synon arritjen e gjendjes së mirë ekologjike dhe kimike të ujërave;
- Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC), e cila rregullon grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura urbane;
- Direktiva për Cilësinë e Ujit të Pijshëm (2020/2184), e cila përcakton standardet për cilësinë dhe sigurinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor;
- Direktiva për Ujërat Nëntokësore (2006/118/EC), e cila synon mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi; si dhe

- direktiva të tjera sektoriale që rregullojnë menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, monitorimin e gjendjes së ujërave, mbrojtjen nga ndotja me nitrate me origjinë bujqësore dhe zbatimin e standardeve të cilësisë mjedisore për substancat ndotëse.

Korniza ligjore dhe institucionale në vend

26. Republika e Kosovës ka një kornizë ligjore relativisht të avancuar për menaxhimin e resurseve ujore, e cila është zhvilluar kryesisht në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me Acquis-in e Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, një numër i konsiderueshëm i direktivave të BE-së në fushën e ujërave janë transpozuar në legjislacionin vendor.

27. Menaxhimi i resurseve ujore dhe ofrimi i shërbimeve të ujit rregullohen nga një sërë aktesh ligjore, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili përbën aktin themelor për administrimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e resurseve ujore; Ligji Nr. 06/L-35 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike; Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit; Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike; Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit; si dhe Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ku, secili në fushën e vet, përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë për menaxhimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve që lidhen me ujërat.

28. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron funksionin ligjvënës dhe mbikëqyrës në këtë sektor, ndërsa Këshilli Ndërministror për Ujëra (KNU), i kryesuar nga kryeministri, koordinon politikat shtetërore dhe reformat për menaxhimin e resurseve ujore.

29. Institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e ujërave është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përmes strukturave të saj përgjegjëse për ujërat. Në kuadër të këtij sistemi vepron edhe Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL), i cili është përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e pellgjeve lumore, administrimin e lejeve ujore dhe mbrojtjen e resurseve ujore.

30. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit ushtrohet nga Inspektorati Qendror i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, ndërsa Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), monitoron gjendjen e ujërave, cilësinë e tyre dhe fenomenet hidrometeorologjike, duke siguruar të dhëna dhe raporte për gjendjen e mjedisit.

31. Në menaxhimin e resurseve ujore ndikon edhe veprimtaria e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), e cila, përmes politikave për ujitjen, pylltarinë dhe menaxhimin e tokës bujqësore, ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

Pasqyrim i rrjetit hidrografik të Kosovës i organizuar në 4 pellgje lumore

32. Bazuar në Raportin për Gjendjen e Ujërave në Kosovë 2020 dhe Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, rrjeti hidrografik i Kosovës organizohet në katër pellgje kryesore lumore, të cilat përbëjnë bazën e menaxhimit të resurseve ujore në vend. Kosova ka një rrjet të dendur lumenjsh, përrenjsh, liqenesh natyrore e artificiale dhe ujërash nëntokësore, megjithatë shpërndarja e tyre nuk është e barabartë. Rrafshi i Dukagjinit konsiderohet zona më e pasur me burime ujore, ndërsa pjesët qendrore dhe lindore të vendit kanë disponueshmëri më të kufizuar të ujit.

Pellgu i Drinit të Bardhë

33. Pellgu i Drinit të Bardhë është pellgu më i madh dhe më i pasur me ujë në Kosovë. Ai shtrihet në pjesën perëndimore të vendit, duke përfshirë Rrafshin e Dukagjinit dhe komunat si Peja, Deçani, Gjakova, Istogu, Klina, Rahoveci, Malisheva dhe Prizreni. Lumi Drini i Bardhë buron në Radavc afër Pejës dhe rrjedh drejt jugperëndimit, duke dalë nga territori i Kosovës në drejtim të Shqipërisë. Degët kryesore të tij janë Lumbardhi i Pejës, Lumbardhi i Deçanit, Lumbardhi i Prizrenit, Lumi Erenik, Mirusha, Klina, Toplluha dhe Lumi i Istogut. Ky pellg karakterizohet nga burime të shumta ujore, akuiferë të zhvilluar dhe potencial i konsiderueshëm për furnizim me ujë, ujitje dhe biodiversitet.

Pellgu i Ibrit

34. Pellgu i Ibrit shtrihet në pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës. Lumi Ibër hyn në Kosovë nga veriu, kalon nëpër Mitrovicë dhe vazhdon drejt Serbisë. Në territorin e Kosovës gjatësia e tij është rreth 42 km, ndërsa pellgu ujëmbledhës ka sipërfaqe rreth 4.035 km². Dega më e madhe është Lumi Sitnica, i cili përshkon pjesën qendrore të Kosovës dhe mbledh ujërat e shumë lumenjve të tjerë, si Llapi, Drenica dhe Graçanka. Në këtë pellg ndodhet edhe Liqeni i Ujmanit (Gazivodës), rezervuari më i madh artificial në Kosovë, me kapacitet rreth 390–395 milionë m³ ujë. Ky liqen ka rëndësi strategjike për furnizimin me ujë të pijshëm, industrinë, ujitjen dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Pellgu i Moravës së Binçës

35. Pellgu i Moravës së Binçës shtrihet në pjesën lindore të Kosovës dhe përfshin kryesisht rajonin e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë dhe Novobërdës. Lumi Morava e Binçës buron në Kosovë dhe rrjedh drejt Serbisë, ku bashkohet me Moravën e Jugut. Degët kryesore të tij janë Binçka, Kriva Reka dhe përroska të tjera të rajonit lindor. Ky pellg karakterizohet nga fusha aluviale dhe depozitime të reja sedimentare, të cilat krijojnë kushte të favorshme për ujërat nëntokësore dhe aktivitetet bujqësore.

Pellgu i Lepencit

36. Pellgu i Lepencit shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, kryesisht në rajonin e Ferizajt dhe Kaçanikut. Lumi Lepenc buron në Malet e Sharrit dhe rrjedh drejt Maqedonisë së Veriut, ku derdhet në Lumin Vardar dhe përfundimisht në Detin Egje. Ky është i vetmi pellg ujëmbledhës i Kosovës që i përket basenit të Detit Egje, ndërsa tri pellgjet e tjera derdhen në basenin e Detit të Zi. Lumi Lepenc ka rëndësi të veçantë për furnizimin me ujë, bujqësinë dhe ekosistemet e Parkut Kombëtar “Sharri”.

Rrjeti lumor dhe karakteristikat e përgjithshme

37. Në tërësi, rrjeti hidrografik i Kosovës përbëhet nga katër pellgje lumore, qindra lumenj e përrenj dhe disa liqene artificiale me rëndësi strategjike, si Batllava, Badovci, Radoniqi dhe Ujmani. Për shkak të pozitës gjeografike, ujërat e Kosovës derdhen në tri dete: pjesa më e madhe e territorit (Drini i Bardhë) i përket basenit të Detit Adriatik, pellgjet e Ibrit dhe Moravës së Binçës i përkasin basenit të Detit të Zi, ndërsa vetëm pellgu i Lepencit i përket basenit të Detit Egje. Megjithëse vendi ka një rrjet të pasur ujërash sipërfaqësore dhe nëntokësore, raportet theksojnë se shpërndarja e tyre është e pabarabartë dhe burimet ujore janë nën presion të vazhdueshëm nga urbanizimi, industria, bujqësia intensive dhe shkarkimi i ujërave të patrajtuara. Për këtë arsye, menaxhimi sipas pellgjeve ujore mbetet parimi kryesor për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore në Kosovë.

Cilësia e ujërave në Kosovë sipas monitorimit të ujërave sipërfaqësore

38. Në përputhje me legjislacionin në fuqi[5], monitorimi i cilësisë së ujërave në Republikën e Kosovës është përgjegjësi e IHMK-së. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor përcakton standardet dhe kërkesat për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga efektet e dëmshme që mund të shkaktohen nga ndotja e ujit, duke garantuar që uji i destinuar për konsum të jetë i sigurt, i shëndetshëm dhe i pastër.

39. Cilësia e ujërave përcaktohet në bazë të analizave fiziko-kimike dhe të metaleve të rënda. Bazuar në Raportin për Gjendjen e Ujërave në Kosovë 2020[6], rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 pika të monitorimit (stacione monitoruese). Parametrat që aktualisht monitorohen janë: i) 10 parametra fizikë - maten 11 herë në vit; ii) 39 parametra kimikë - maten 11 herë në vit; dhe iii) 8 metale të rënda - maten 2 herë në vit.

40. Bazuar në Raportin "Gjendja e Ujërave në Kosovë 2020[7] të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)", gjendja e ujërave në Kosovë vlerësohet si shqetësuese, megjithëse me dallime të dukshme ndërmjet pellgjeve lumore dhe rrjedhave të ndryshme. Raporti konstaton se burimet ujore përbëjnë një pasuri të rëndësishme natyrore, por cilësia e ujërave sipërfaqësore është e cenuar në shumë zona, kryesisht si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza të patrajtuara, ndotjes industriale dhe aktiviteteve bujqësore. Monitorimi tregon se cilësia e ujit është përgjithësisht më e mirë në pjesët burimore të lumenjve, ndërsa përkeqësohet ndjeshëm pas kalimit nëpër zonat urbane dhe industriale, ku vërehen tejkalime të parametrave fizikë, kimikë dhe mikrobiologjikë. Në të njëjtën kohë, raporti thekson se Kosova ka resurse të rëndësishme ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, por shpërndarja e tyre është e pabarabartë dhe potenciali i tyre ende nuk është studiuar dhe shfrytëzuar plotësisht.

41. Në vijim janë të paraqitura të dhënat e përgjithshme lidhur me cilësinë e ujërave sipërfaqësore, te cilat janë evidentuar në raportin e AMMK-së të vitit 2020.

Pellgu i Lumit Drini i Bardhë

42. Pellgu i Lumit Drini i Bardhë është pellgu më i madh lumor në Kosovë dhe monitorohet në 10 lumenj. Monitorimi evidenton dallime të konsiderueshme në cilësinë e ujërave ndërmjet pjesëve burimore dhe rrjedhave të poshtme, ku ndikimi i shkarkimeve urbane, industriale dhe eksploatimit të zhavorrit është më i theksuar.

    - Lumi i Istogut - lumi më i pastër në Kosovë, me cilësi shumë të mirë përgjatë gjithë rrjedhës.
    - Lumi Klina - cilësi e dobët për shkak të ndikimit të aktiviteteve njerëzore.
    - Lumbardhi i Pejës - ndotje nga ujërat urbane dhe industriale, përkeqësim i cilësisë dhe turbullirë gjatë sezonit të eksploatimit të zhavorrit.
    - Lumi Mirusha - cilësi mesatare, me turbullirë të lehtë.
    - Lumbardhi i Deçanit - cilësi përgjithësisht e mirë, por me rritje të turbullirës si pasojë e nxjerrjes së zhavorrit.

[5] Neni 35 i Ligjit Nr. 04/147 për Ujërat e Kosovës.

[6] https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB.pdf

[7] https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Shqip_WEB.pdf

- Lumi Erenik - ndotje nga detergjentet dhe shkarkimet industriale, me shkumë të vazhdueshme në sipërfaqe.
- Lumi Rimnik - përmbajtje e ulët e oksigjenit dhe koncentrime të larta të amoniumit e fosfateve.
- Lumi Toplluha - cilësi shumë e mirë në pjesën burimore, por përkeqësim dhe turbullirë e vazhdueshme nga eksploatimi i zhavorrit.
- Lumbardhi i Prizrenit - përkeqësim i ndjeshëm i cilësisë për shkak të shkarkimeve të ujërave të ndotura.

Pellgu i Lumit Ibër

43. Pellgu i Lumit Ibër monitorohet në 7 lumenj (Ibër, Sitnicë, Llap, Prishtevkë, Graçankë, Drenicë dhe Shtime). Statusi i përgjithshëm i trupave ujorë vlerësohet i dobët, kryesisht si pasojë e shkarkimeve urbane, industriale dhe mbeturinave.
    - Lumi Ibër - cilësi përgjithësisht e kënaqshme, me përkeqësim pas shkarkimeve urbane.
    - Lumi Sitnicë - lumi më i ndotur në Kosovë, me tejkalime të materieve të suspenduara dhe ndikim të madh nga shkarkimet urbane e industriale.
    - Lumi Llap - nuk janë evidentuar tejkalime të vlerave maksimale të lejuara.
    - Lumi Prishtevkë - ndër lumenjtë më të ndotur; tejkalime të nitriteve, materieve të suspenduara, $SHBO_5$, SHKO, mungesë oksigjeni të tretur dhe prani detergjentesh.
    - Lumi Graçankë - ndotje nga ujërat e minierave dhe shkarkimet e vendbanimeve; përçueshmëri elektrike dhe sulfate të larta.
    - Lumi Drenicë - ndotje permanente nga shkarkimet urbane, Ferronikeli dhe aktivitetet e KEK-ut.
    - Lumi Shtime - cilësi shumë e mirë në burim, ndërsa përkeqësohet ndjeshëm pas shkarkimeve urbane.

Pellgu i Lumit Morava e Binçës

44. Pellgu i Moravës së Binçës monitorohet në 2 lumenj. Presionet kryesore lidhen me shkarkimet urbane, industriale dhe ndikimin e aktiviteteve minerare.
    - Morava e Binçës - ndotje nga shkarkimet urbane dhe industriale të Gjilanit, Vitisë dhe Dardanës.
    - Kriva Reka - ndotje e lartë nga ujërat e minierës së Artanës; ulje e pH-së, prani e metaleve të rënda, turbullirë, amoniak dhe nitrite.

Pellgu i Lumit Lepenc

45. Pellgu i Lepencit monitorohet në 2 lumenj. Cilësia e ujërave është përgjithësisht e mirë në pjesët burimore, por përkeqësohet pas shkarkimeve urbane dhe industriale.
    - Lumi Lepenc - turbullirë nga shkarkimet e fabrikës “Silkapor”, ndërsa në pjesën kufitare cilësia mbetet brenda kufijve të lejuar.
    - Lumi Nerodime - cilësi e lartë në burim, me përkeqësim pas shkarkimeve urbane të rajonit të Ferizajt.

46. Raporti vlerëson se sfida kryesore mbetet mungesa e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura. Pjesa më e madhe e ujërave të zeza urbane vazhdon të shkarkohet në lumenj pa trajtim paraprak, ndërsa niveli i trajtimit të tyre konsiderohet shumë i ulët. Në raport theksohet se investimet në impiante të trajtimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të adresuar këtë problem, duke bërë që ndotja e lumenjve të vazhdojë dhe të ndikojë negativisht në cilësinë e ujërave dhe ekosistemeve ujore. Për këtë arsye, raporti rekomandon forcimin e monitorimit, zgjerimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura, zbatimin më efektiv të legjislacionit dhe rritjen e investimeve për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

47. Bazuar në raportin "Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Kosovë" (ARPL, mars 2026), ndotja nga ujërat e zeza urbane vlerësohet si një nga sfidat më serioze për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore në Kosovë. Raporti thekson se, pavarësisht përmirësimeve në vitet e fundit, një pjesë e konsiderueshme e ujërave të zeza të gjeneruara nga ekonomitë familjare, aktivitetet komerciale dhe institucionet vazhdon të shkarkohet pa trajtim adekuat në lumenj dhe përrenj. Si pasojë, shkaktohet ndotje e vazhdueshme e trupave ujorë, rritje e ngarkesës me lëndë ushqyese dhe degradim i gjendjes ekologjike të ekosistemeve ujore. Sipas këtij raporti ulja e ndotjes nga ujërat e zeza urbane kërkon jo vetëm investime infrastrukturore, por edhe planifikim të koordinuar ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, prioritizim të investimeve sipas nivelit të rrezikut mjedisor dhe zbatim të plotë të standardeve të Bashkimit Evropian për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza[8].

48. Në aspektin e përgjegjësive lokale, raporti nënvizon nevojën që komunat të ndërmarrin veprime konkrete për reduktimin e ndotjes nga ujërat e zeza, përmes: zgjerimit të rrjeteve publike të kanalizimit dhe lidhjes së zonave që ende nuk janë të mbuluara; mbështetjes dhe përshpejtimit të ndërtimit e funksionalizimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza; parandalimit të shkarkimeve të drejtpërdrejta të ujërave të zeza në lumenj dhe përrenj; planifikimit dhe prioritizimit të investimeve komunale në infrastrukturën e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza; bashkëpunimit me nivelin qendror. Sipas këtij raporti, rekomandohet që prioritet t'u jepet aglomerateve me mbi 2,000 ekuivalentë banorësh (PE), të cilat nuk kanë trajtim adekuat të ujërave të zeza, pasi këto konsiderohen burimet me ndikimin më të madh në mosarritjen e objektivave mjedisore për cilësinë e ujërave[9].

49. Lidhur me degradimin e lumenjve nga eksploatimi i zhavorrit, AMMK-ja, në Raportin për vitin 2022 *"Ndikimi i Shfrytëzuesve të Rërës dhe Zhavorit në Gjendjen Mjedisore të Lumenjve"*, ka theksuar se eksploatimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit ka shkaktuar degradim të konsiderueshëm të shtretërve të lumenjve dhe të tokave përreth tyre. Raporti identifikon si më të degraduarit lumenjtë Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Ereniku, Morava e Binçës, Desivojca, Krivareka dhe Ibri. Sipas raportit, vlerësohet se Drini i Bardhë dhe Lumbardhi i Pejës kanë pësuar dëmet më të mëdha, me sipërfaqe të degraduara prej 1.393.04 ha, përkatësisht 257.12 ha, të cilat së bashku përbëjnë rreth 94% të sipërfaqes së përgjithshme të degraduar nga ky aktivitet. Raporti thekson gjithashtu se dëmtime evidente nga eksploatimi i inerteve janë konstatuar edhe në rrjedhat e poshtme të

[8] *ARPL - "Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Kosovë - Raport i Përkohshëm për Konsultim Publik"*, 2026: https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DivisionDocs/2026_602b0113-58d8-4de0-810e-5ce2f9ab7ee7.pdf

[9] Po aty.

Moravës së Binçës, Krivarekës, Desivojcës dhe, në një masë më të kufizuar, në Lepenc. Trendi i degradimit ka vazhduar edhe pas vitit 201[10].

50. Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024 të AMMK-së[11], gjendja e ujërave sipërfaqësore në Kosovë vazhdon të mbetet sfiduese, si pasojë e presioneve të vazhdueshme nga urbanizimi, aktivitetet industriale dhe bujqësore, si dhe nga shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim adekuat. Raporti vlerëson se burimi kryesor i ndotjes së lumenjve vazhdon të jetë shkarkimi i ujërave të patrajtuara, i cili ndikon në rritjen e materieve organike dhe inorganike në ujë, duke reflektuar përkeqësim të cilësisë së ujërave, veçanërisht në lumenjtë që kalojnë nëpër zona të banuara dhe industriale. Më konkretisht raporti thekson: *"Problemi më kritik aktual është ndotja e ujërave siperfaqësor që shkaktohet nga shkarkimi i ujërave, presionet e tilla vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujor."*

51. Sipas monitorimit të realizuar nga IHMK-ja në 54 stacione monitoruese, gjendja më e rënduar është evidentuar në pellgun e Lumit Ibër, ku janë regjistruar tejkalimet më të mëdha të parametrave të ndotjes organike. Raporti identifikon si më problematikë Lumin Prishtevka, në stacionin monitorues në Bresje, dhe Lumin Graçanka, në stacionin monitorues në Vragoli, të cilët janë vlerësuar si trupat ujorë me nivelin më të lartë të ndotjes në vend. Në këto stacione janë regjistruar tejkalime të konsiderueshme të parametrave në Shpenzimin Biokimik të Oksigjenit (SHBO5) dhe Shpenzimin Kimik të Oksigjenit (SHKO), si dhe përqendrime të larta të karbonit organik, fosforit total dhe materieve të ngurta të suspenduara, duke dëshmuar ngarkesë të madhe me ndotje organike. Raporti e lidh këtë gjendje me shkarkimin e ujërave të zeza të patrajtuara, ndikimin e aktiviteteve industriale dhe dendësinë e lartë të popullsisë përgjatë këtyre lumenjve.

52. Raporti evidenton se edhe Lumi Sitnica, si lumi kryesor i pellgut të Ibrit, vazhdon të jetë nën presion të vazhdueshëm nga shkarkimet e ujërave të ndotura dhe ndikimet antropogjene. Megjithëse parametrat më kritikë janë regjistruar në degët e tij, veçanërisht në Prishtevkë dhe Graçankë, rezultatet e monitorimit tregojnë se edhe Sitnica paraqet shenja të ndotjes organike përgjatë rrjedhës së saj, si pasojë e shkarkimeve komunale dhe industriale.

53. Në pellgun e Drinit të Bardhë, monitorimi ka treguar se përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë dhe Erenikut vërehet rritje graduale e parametrave të ndotjes, veçanërisht e Shpenzimit Kimik të Oksigjenit (SHKO), ndërsa stacionet referente pranë burimeve paraqesin cilësi dukshëm më të mirë të ujit. Megjithatë, raporti nuk i klasifikon këta lumenj ndër më të ndoturit në Kosovë dhe vlerëson se në këtë pellg janë evidentuar përmirësime të cilësisë së ujërave si rezultat i funksionalizimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në Pejë, Gjakovë dhe Prizren.

54. Për sa i përket pellgut të Moravës së Binçës, monitorimi ka evidentuar rritje të vlerave të SHKO-së përgjatë rrjedhës së lumit, çka tregon ndikim të aktiviteteve njerëzore dhe

[10] AMMK - *"Ndikimi i Shfrytëzuesve të Rërës dhe Zhavorit në Gjendjen Mjedisore të Lumenjve", 2022:* https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raportipergjendjenelumenjeve2022(alb).pdf

[11] https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20vjetor%20i%20gjendjes%20se%20mjedisit%202024%20al.pdf

shkarkimeve të ujërave të ndotura. Një situatë e ngjashme është evidentuar edhe në pellgun e Lepencit, ku në lumenjtë Lepenc dhe Nerodime janë regjistruar rritje të parametrave të ndotjes organike përgjatë rrjedhës së tyre. Megjithatë, raporti vlerëson se niveli i ndotjes në këto pellgje mbetet më i ulët krahasuar me pellgun e Ibrit dhe nuk paraqet tejkalime aq të theksuara sa ato të evidentuara në Prishtevkë dhe Graçankë.

55. Në përgjithësi, raporti evidenton se Prishtevka (në Bresje) dhe Graçanka (në Vragoli) janë lumenjtë ku janë evidentuar tejkalimet më të mëdha të parametrave të cilësisë së ujit dhe që paraqesin gjendjen më të rënduar mjedisore në Kosovë. Ndërkohë, lumenjtë e tjerë të monitoruar shfaqin shkallë të ndryshme të ndotjes, kryesisht në pjesët që kalojnë nëpër zona urbane dhe industriale, ndërsa cilësia e ujit është dukshëm më e mirë në pjesët burimore dhe në stacionet referente.

56. Sipas raportit "Statistikat e Ujërave në Kosovë 2023-2024", të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), infrastruktura për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë mbetet ende e kufizuar. Sipas ASK-së, për periudhën raportuese 2023-2024 funksiononin katër impiante për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, të vendosura në Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Skenderaj, ndërsa në shumicën e komunave të tjera ujërat e zeza vazhdojnë të shkarkohen drejtpërdrejt në lumenj, duke përbërë një nga burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore. Raporti po ashtu evidenton se gjatë vitit 2024 janë shkarkuar gjithsej 58.7 milionë m³ ujëra të zeza, nga të cilat pjesa më e madhe (47.4 milionë m³) vjen nga ekonomitë familjare, çka nënvizon nevojën për zgjerimin e kapaciteteve për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në nivel vendi[12].

57. Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025, evidenton gjithashtu një sërë sfidash që vazhdojnë të pengojnë mbrojtjen efektive të ujërave. Ndër më kryesorët janë: kuadri ligjor ende i paplotësuar dhe jo plotësisht i harmonizuar me Acquis të BE-së; kapacitetet e pamjaftueshme institucionale dhe njerëzore në MMPHI, ARPL dhe IHMK; mungesa e inspektorëve të ujërave, veçanërisht në nivel komunal; mungesa e të dhënave të plota dhe monitorimit sistematik të cilësisë dhe sasisë së ujërave; mosfinalizimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore; shkalla e ulët e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve strategjike; ndotja e vazhdueshme e lumenjve me ujëra të patrajtuara dhe mbeturina; degradimi i shtretërve të lumenjve nga nxjerrja e pakontrolluar e inerteve; humbjet e larta të ujit në rrjetet e furnizimit; kapacitetet e kufizuara për kontrollin e erozionit dhe menaxhimin e përmbytjeve; si dhe ndikimi në rritje i ndryshimeve klimatike në disponueshmërinë dhe sigurinë e resurseve ujore. Dokumenti thekson se adresimi i këtyre sfidave është parakusht për arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave dhe përmbushjen e standardeve evropiane në këtë sektor.

58. Avokati i Popullit ka vërejtur se, më 8 prill 2026, MMPH-ja ka nxjerrë Vendimin për pezullimin e përkohshëm të të gjitha punimeve në shtretërit e lumenjve për projektet ekzistuese ku përdoret betoni, me të cilin është urdhëruar pezullimi i punimeve në segmentet që nuk kanë përfunduar 90% të punimeve. Me këtë vendim, ministria ka ndaluar gjithashtu planifikimin, projektimin, miratimin, financimin dhe lëshimin e pëlqimeve ujore për projektet e reja që parashohin betonimin e shtretërve të lumenjve, me përjashtim të rasteve të autorizuara posaçërisht, si dhe ka iniciuar bashkëpunim me komunat dhe operatorët ekonomikë për rishikimin e projekteve të pezulluara. Në

[12] https://askapi.rks-gov.net/Custom/d840d14d-28a1-48f3-9e2d-7e409ed9bca0.pdf

arsyetimin e vendimit, ministria ka konstatuar se praktikat e deritanishme të betonimit të shtretërve të lumenjve kanë shkaktuar degradim të ekosistemeve ujore, kanë cenuar ujërat nëntokësore, kanë dëmtuar habitatet e florës dhe faunës lumore, si dhe kanë rritur rrezikun nga vërshimet. Sipas ministrisë, pezullimi i punimeve synon përshtatjen e projekteve me standardet mjedisore dhe zbatimin e metodave ekologjike për mbrojtjen e ekosistemeve lumore, në përputhje me legjislacionin vendor dhe Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat[13].

Raportimet mediale lidhur me ndotjen e lumenjve në vend

59. Bazuar në raportimet mediale të publikuara gjatë dy viteve të fundit, gjendja e lumenjve në Kosovë vazhdon të paraqitet shqetësuese, me theks të veçantë në ndotjen nga ujërat e zeza të patrajtuara, hedhjen e mbeturinave të ngurta, shkarkimet industriale dhe degradimin e shtretërve të lumenjve. Raportimet investigative kanë evidentuar se ndotja nuk kufizohet vetëm në zona të caktuara, por prek disa prej lumenjve kryesorë të vendit, duke ngritur shqetësime për ndikimin në shëndetin publik, biodiversitetin dhe cilësinë e burimeve ujore. Në vazhdimësi është raportuar se mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura dhe zbatimi i pamjaftueshëm i legjislacionit mjedisor mbeten ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë në përkeqësimin e gjendjes së lumenjve[14].

60. Një vëmendje e veçantë në media i është kushtuar lumit Drini i Bardhë, i cili, megjithëse njihet si një nga lumenjtë më të rëndësishëm të vendit, është raportuar se përballet me ndotje të konsiderueshme nga shkarkimet e ujërave të zeza nga disa komuna, mbeturinat e ngurta dhe mbetjet industriale, të cilat transportohen më tej edhe drejt territorit të Shqipërisë. Raportimet kanë dokumentuar gjithashtu grumbullimin e sasive të mëdha të mbeturinave në shtratin e lumit dhe degradimin e vazhdueshëm të ekosistemit ujor, duke theksuar nevojën për ndërhyrje urgjente dhe masa efektive për mbrojtjen e burimeve ujore[15].

61. Në një reportazh investigativ të publikuar nga Kallxo/BIRN, është raportuar se lumi Drini i Bardhë, i njohur dikur për pastërtinë e tij, është shndërruar në një nga lumenjtë më të ndotur në Kosovë. Sipas këtij raportimi, lumi përballet me shkarkime të ujërave të zeza nga tetë komuna, mbetje industriale, mbeturina komunale dhe pluhur nga aktivitetet e nxjerrjes së zhavorrit, të cilat transportohen përgjatë rrjedhës së lumit deri në Liqenin e Fierzës në Shqipëri. Në raportim theksohet se kjo gjendje ka ndikuar jo vetëm në degradimin e cilësisë së ujit dhe ekosistemit ujor, por edhe në peshkim, biodiversitet dhe shëndetin e komuniteteve që jetojnë përgjatë lumit[16].

62. Një tjetër raportim i publikuar nga organizata Ec Ma Ndryshe, i cili është pasqyruar edhe nga media, vlerëson se burimet ujore të Kosovës po përballen me presion të vazhdueshëm si pasojë e ndotjes, ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të pamjaftueshëm institucional. Sipas raportimit, sfidat kryesore lidhen me shkarkimin e ujërave të ndotura, hedhjen e mbeturinave, shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve natyrore, mungesën e koordinimit ndërinstitucional dhe zbatimin jo të plotë të legjislacionit mjedisor. Raporti evidenton se lumenjtë kryesorë, përfshirë Drinin e Bardhë, Lumbardhin e Prizrenit dhe Toplluhën, janë ndër më të prekurit nga këto presione, ndërsa paralajmëron se degradimi i

[13] https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2026_06f387d9-7f37-469b-a9fc-f94fb2585a61.pdf
[14]https://earthjournalism.net/stories/the-white-drin-river-in-kosovo-not-so-clear-anymore
[15] https://prishtinainsight.com/a-flowing-landfill-once-pristine-kosovo-river-turned-into-pollution-exporter-mag/
[16] https://kallxo.com/gjate/reportazh/deponi-qe-rrjedh-drini-i-bardhe-shnderrohet-ne-eksportues-ndotjeje/

vazhdueshëm i ekosistemeve ujore rrezikon biodiversitetin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore[17].

63. Raportimet mediale kanë trajtuar gjithashtu edhe degradimin fizik të shtretërve të lumenjve si rezultat i nxjerrjes së paligjshme të zhavorrit. Në fund të vitit 2025, mediat raportuan për aksionin e organeve të rendit ndaj personave të dyshuar për degradimin e mjedisit në zonën e Drinit të Bardhë, duke evidentuar se aktivitetet e paligjshme të nxjerrjes së zhavorrit vazhdojnë të paraqesin rrezik serioz për stabilitetin e shtratit të lumit, cilësinë e ujit dhe ekosistemin përreth. Ky rast u raportua si pjesë e përpjekjeve të institucioneve për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të lumenjve dhe për të zbatuar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit[18].

64. Në një artikull të publikuar nga Telegrafi, me titull: *"Raportime të shumta nga qytetarët për ndotje të lumenjve"*, është raportuar se qytetarët e komunave të ndryshme kanë vazhduar të denoncojnë raste të ndotjes së mjedisit, përmes platformës Ndreqe.com, duke evidentuar, ndër të tjera, ndotjen e Lumit Sitnica në fshatin Plemetin (Komuna e Obiliqit). Sipas raportimit, lumenjtë në Kosovë janë shndërruar në vende ku hidhen mbeturina nga qytetarë dhe subjekte të papërgjegjshme, ndërsa raste të ngjashme të shkeljeve mjedisore janë raportuar edhe nga komuna të tjera. Artikulli thekson se raportimi i vazhdueshëm i qytetarëve synon të nxisë reagimin e institucioneve kompetente dhe të kontribuojë në parandalimin e degradimit të mëtejshëm të mjedisit[19].

65. Në artikullin e publikuar më 18 maj 2026, me titull: "*Gjendje shqetësuese e lumenjve në Kosovë*", u pasqyruan gjetjet e hulumtimeve të fundit mbi gjendjen e lumenjve, sipas të cilave degradimi i tyre po thellohet si pasojë e ndotjes dhe ndërhyrjeve të pakontrolluara në shtretërit e lumenjve. Artikulli i referohet hulumtimit të organizatës mjedisore Ecopana, sipas të cilit vetëm në pellgun e Drinit të Bardhë janë identifikuar 142 diga dhe pengesa artificiale, të cilat, megjithëse ishin ndërtuar për qëllime ujitjeje, nuk e kryejnë më këtë funksion dhe pengojnë rrjedhën natyrore të lumit. Në raportim theksohen gjithashtu vlerësimet e ekspertëve, të cilët paralajmërojnë se ndërhyrjet njerëzore, ndotja e vazhdueshme dhe mungesa e vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis po dëmtojnë rëndë ekosistemet ujore, florën dhe faunën, ndërsa theksohet se degradimi i lumenjve ndikon drejtpërdrejt edhe në cilësinë e ujit të përdorur nga qytetarët. Sipas ekspertëve të cituar në artikull, pa masa të menjëhershme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tyre, lumenjtë rrezikojnë të humbin funksionin e tyre ekologjik dhe biodiversitetin që mbështesin[20].

66. Më 18 maj 2026, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) publikoi një reportazh me titull "*Gjendje shqetësuese e lumenjve: Studimet tregojnë degradim të lumenjve për shkak të ndotjes dhe ndërhyrjeve të pakontrolluara*."[21]

Ndikimi i hidrocentraleve në mjedis dhe ujëra

[17] https://telegrafi.com/organizata-ec-ma-ndryshe-ujerat-e-kosoves-nen-presion-nga-ndotja-dhe-ndryshimet-klimatike/

[18] https://telegrafi.com/ojq-ec-me-ndryshe-raporti-i-be-se-konfirmon-sfidat-e-kosoves-ne-fushen-e-mjedisit-dhe-ndryshimeve-klimatike/

[19] https://telegrafi.com/raportime-te-shumta-nga-qytetaret-per-ndotje-te-lumenjve/

[20] https://storm-rks.com/gjendje-shqetesuese-e-lumenjve-ne-kosove/

[21] https://www.facebook.com/watch/?v=960695760094452

67. Në Kosovë, ashtu si edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, gjatë 10-15 viteve të fundit është shënuar një rritje e konsiderueshme e investimeve në ndërtimin e hidrocentraleve[22] të vogla (HEC) me kapacitet deri në 10 MW. Ky zhvillim vlerësohej për përmbushjen e objektivave në fushën e energjisë së ripërtëritshme, në përputhje me detyrimet që rridhnin nga direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, përkatësisht Direktivën 2001/77/EC dhe Direktivën 2009/28/EC. Në këtë drejtim, Plani Veprues Kombëtar për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020 parashihte që deri në vitin 2020, 25% e konsumit të përgjithshëm të energjisë në Kosovë të sigurohej nga burimet e ripërtëritshme, përfshirë energjinë hidrike, të erës, diellore, biomasën dhe energjinë gjeotermale. Për realizimin e këtij objektivi u miratuan një sërë masash ligjore dhe rregullatore, të cilat synonin të nxisnin investimet në prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, përfshirë aplikimin e mekanizmave mbështetës, siç ishin tarifat stimuluese (feed-in tariffs).

68. Megjithëse hidrocentralet konsiderohen një burim i rëndësishëm i energjisë së ripërtëritshme dhe një alternativë më e favorshme nga aspekti i reduktimit të emetimeve të gazeve serrë, ndërtimi dhe funksionimi i tyre në Kosovë është shoqëruar me ndikime të konsiderueshme në mjedis. Në shumë raste janë evidentuar mangësi në procesin e vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis, veçanërisht në aspektin e analizës cilësore dhe gjithëpërfshirëse të alternativave të mundshme të realizimit të projekteve, me qëllim të përzgjedhjes së zgjidhjes që do të siguronte ndikimin më të vogël të mundshëm në mjedis. Gjithashtu, janë konstatuar dobësi edhe në monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara në lejet mjedisore dhe ato ujore, duke mos u evidentuar një kontroll efektiv dhe i vazhdueshëm nga autoritetet kompetente për të siguruar respektimin e tyre gjatë fazës së operimit të hidrocentraleve.

69. Po ashtu, është konstatuar se zhvillimi i projekteve për ndërtimin e hidrocentraleve nuk ka qenë i harmonizuar me dokumentet strategjike për planifikimin dhe menaxhimin e resurseve ujore. Në këtë drejtim janë evidentuar këto mangësi kryesore:

- Ndërtimi në lokacione të parapara për infrastrukturë strategjike ujore. Disa hidrocentrale janë ndërtuar në zona të planifikuara për realizimin e objekteve strategjike hidroteknike, përfshirë lokacionin e paraparë për hidrosistemin në Lumin Lepenc, duke krijuar pengesa dhe rrezikuar realizimin e projekteve me rëndësi strategjike për Republikën e Kosovës.

- Ndërtimi në zona të mbrojtura. Në raste të caktuara, hidrocentralet janë ndërtuar brenda zonave të mbrojtura të parqeve kombëtare, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe me dokumentet e planifikimit hapësinor të miratuara nga autoritetet kompetente.

- Moszbatimi i procedurës së koncesionit. Dhënia e së drejtës për shfrytëzimin e burimeve ujore për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ujërat e Kosovës, pasi nuk është zbatuar procedura e koncesionit, e cila garanton një proces konkurrues, transparent dhe të barabartë për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të ujit.

[22] Sipas një raporti të hartuar në vitin 2019, https://balkanrivers.net/sites/default/files/who-pays-who-profits.pdf, prej vitit 2009 deri në vitin 2018 janë ndërtuar së paku 380 hidrocentale të vogla në vendet e Ballkanit (Shqiperi, Maqedoni, Mal i Zi, Bosnje, Kosovë, Serbi).

70. Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe procedurave të ndjekura për lejimin e hidrocentraleve, MMPHI-ja, në qershor 2021, publikoi një raport, në të cilin vërehet se ka analizuar procesin e dhënies së lejeve për hidrocentralet, nëpërmjet një grupi punues të themeluar nga ministri[23]. Raporti evidentoi një sërë mangësish të rëndësishme në procesin e planifikimit, lejimit dhe mbikëqyrjes së hidrocentraleve. Ndër gjetjet kryesore janë evidentuar: a) MMPH, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës, ka dhënë të drejtën për shfrytëzimin e ujit për hidrocentrale përmes lejeve ujore dhe jo përmes procedurës së koncesionit, duke shmangur procesin konkurrues të paraparë me ligj; b) Lejet ujore janë lëshuar edhe në kundërshtim me aktet nënligjore, pa dokumentacionin dhe përmbajtjen e kërkuar ligjore; c) Lejet janë miratuar pa analiza të mjaftueshme profesionale dhe pa u bazuar në dokumentet planifikuese, duke mundësuar ndërtimin e hidrocentraleve edhe në zona të planifikuara për projekte strategjike ujore, përfshirë Hidrosistemin e Lepencit; d) Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) ka qenë i mangët, për shkak të mungesës së udhëzuesve dhe standardeve të qarta, ndërsa raportet e VNM-së nuk kanë trajtuar në mënyrë adekuate ndikimet në ekosistemet ujore; e) Për hidrocentralet e kaskadës së Deçanit janë lëshuar leje ndërtimore nga Ministria, ndonëse, sipas ligjit, kjo kompetencë i takonte komunës për objektet me kapacitet nën 10 MW; dhe f) Hidrocentralet janë ndërtuar në afërsi të menjëhershme të lumenjve, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës, i cili ndalon ndërtimin brenda brezit mbrojtës prej 30 metrash nga vijat e ujërave maksimale[24].

71. Në Raportin me Rekomandime Ex Officio nr. 365/2018, të publikuar më 3 shkurt 2021, Avokati i Popullit trajtoi ligjshmërinë e procedurave që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e hidrocentraleve, si dhe ankesat e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi. Raporti evidentoi mangësi të vazhdueshme procedurale, mungesë transparence dhe mosrespektim të standardeve të të drejtave të njeriut, veçanërisht në raport me të drejtën për informim dhe pjesëmarrjen e publikut në çështjet mjedisore. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit rekomandoi që autoritetet kompetente të sigurojnë transparencë të plotë, respektimin e procedurave ligjore dhe trajtimin me prioritet të rasteve gjyqësore që lidhen me hidrocentralet. Po ashtu, më 17 korrik 2019, Avokati i Popullit i ishte drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme lidhur me këtë çështje[25].

72. Ndërsa në Raportin me rekomandime "*Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës*", të publikuar më 10 dhjetor 2021, Avokati i Popullit vlerësoi se pandemia, e kombinuar me mangësitë ekzistuese institucionale, kishte dobësuar mbikëqyrjen inspektuese dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor, duke mundësuar vazhdimin e aktiviteteve me ndikim në mjedis, përfshirë hidrocentralet. Raporti theksoi se ndikimi i tyre në burimet ujore paraqet rrezik për

[23] https://www.ammk-rks.net/al/lajmi-single/526

[24] Po aty.

[25]https://oik-rks.org/2021/02/03/raport-me-rekomandime-ex-officio-3652018-kunder-ministrise-se-ekonomise-dhe-ambientit-lidhur-me-ceshtjen-e-ligjshmerise-se-procedurave-qe-kane-te-bejne-me-hidrocentralet-ne-vend-dhe-qasjes-ne-dokum/

mjedisin dhe për realizimin e së drejtës për ujë të pastër, si dhe ngriti shqetësime për respektimin e standardeve të Konventës së Aarhus-it[26].

73. Avokati i Popullit, nëpërmjet raporteve të lartpërmendura, ka vlerësuar se zhvillimi i projekteve të hidrocentraleve në Kosovë është shoqëruar me paqartësi dhe mangësi në aspektin e ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Pavarësisht reagimeve të vazhdueshme të qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave, autoritetet kompetente nuk kanë ofruar sqarime të mjaftueshme lidhur me ligjshmërinë e funksionimit të hidrocentraleve. Raportet institucionale dhe ankesat e publikut kanë evidentuar shqetësime të vazhdueshme për shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve ujore, degradimin e disa lumenjve, mosrespektimin e legjislacionit dhe dokumenteve planifikuese, si dhe ndikimin negativ në prurjen minimale ekologjike[27], si dhe në ekosistemet ujore.

74. Sipas raportit "Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Kosovë" (Raport i përkohshëm për konsultim publik), të publikuar nga ARPL-ja në mars 2026, hidrocentralet identifikohen si një nga burimet kryesore të presioneve hidromorfologjike mbi trupat ujorë. Raporti vlerëson se ndërtimi i digave, devijimi i rrjedhës së lumenjve dhe strukturat e tjera të lidhura me hidrocentralet ndryshojnë regjimin natyror të rrjedhës, ndërpresin vazhdimësinë e lumenjve, ndikojnë në transportin e sedimenteve dhe cenojnë habitatet ujore e bregore, duke ndikuar në gjendjen ekologjike të ujërave sipërfaqësore. Raporti thekson se pellgu i Drinit të Bardhë është më i ekspozuari ndaj këtyre presioneve hidromorfologjike, kryesisht për shkak të përqendrimit të hidrocentraleve të vogla dhe ndërhyrjeve të tjera në rrjedhat ujore. Në këtë drejtim, rekomandohet forcimi i monitorimit të ndryshimeve hidromorfologjike dhe integrimi i kërkesave për ruajtjen e rrjedhës mjedisore në procesin e menaxhimit të pellgjeve lumore, me qëllim mbrojtjen e gjendjes së mirë ekologjike të lumenjve në përputhje me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat[28].

75. AMMK-ja, në raportin "Gjendja e Ujërave në Kosovë 2020", të publikuar në vitin 2021, trajton hidrocentralet në kuadër të shfrytëzimit të resurseve ujore për hidroenergjetikë. Raporti evidenton se në kohën e hartimit të tij, në Kosovë ishin në funksion shtatë hidrocentrale, ndërsa dymbëdhjetë të tjera ishin në ndërtim, duke paraqitur të dhëna për kapacitetet dhe vendndodhjen e tyre. Megjithëse raporti nuk ofron një analizë të detajuar të ndikimit të hidrocentraleve në cilësinë e ujërave apo në secilin lumë, ai në rekomandimet e tij thekson se lejet për shfrytëzimin e ujit për hidrocentrale duhet të lëshohen vetëm në rastet kur nuk dëmtohet ekosistemi ujor i lumenjve dhe respektohet minimumi biologjik (prurja ekologjike). Përmes këtij rekomandimi, raporti nënvizon nevojën që zhvillimi i projekteve hidroenergjetike të balancohet me mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe ruajtjen e gjendjes së mirë të trupave ujorë.

76. Ndikimi i hidrocentraleve në mjedis, mangësitë në garantimin e së drejtës për qasje në informata, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi, si dhe

[26] https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/

[27] *Prurja e pranueshme ekologjike* paraqet një rrjedhje minimale që duhet të sigurohet çdoherë në lumë për ruajtjen e mjedisit natyror. Kjo prurje është kategori ligjore e sanksionuar me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 65), si dhe me *Rregulloren nr.02/2016 për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike* - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12804

[28] https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/OtherDocuments/SHQIP_Raporti_SWMI_9-Mars-2026.pdf

shqetësimet e vazhdueshme të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, janë evidentuar edhe në raportet e Avokatit të Popullit, në të cilat është theksuar nevoja që autoritetet publike të balancojnë interesin ekonomik me interesin publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

77. Avokati i Popullit vlerëson se dëmtimi i mjedisit dhe ndërhyrjet në hapësirat publike, pa vlerësuar në mënyrë të duhur interesin publik dhe të drejtat e komuniteteve lokale, cenojnë të drejtën për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, e cila është njohur si e drejtë universale e njeriut nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2022.

78. Avokati i Popullit ka vërejtur se, më 27 prill 2026, MMPH-ja ka nxjerrë Vendimin për Fillimin e Zbatimit të Procedurave për Ndërprerjen e Lejes Ujore të Hidrocentraleve të Vogla, me të cilin ka vendosur që hidrocentralet e vogla me derivacion të futen në procedurën e ndërprerjes së lejes ujore nëse, brenda afatit gjashtëmujor, nuk arrijnë të zbatojnë kriteret për përcaktimin e prurjes së pranueshme ekologjike, përfshirë instalimin e pajisjeve ujëmatëse. Vendimi obligon operatorët të korrigjojnë veprat ujëmarrëse në mënyrë që të sigurohet prurja ekologjike përpara shfrytëzimit të ujit për prodhim të energjisë, ndërsa vazhdimi i operimit kushtëzohet me verifikimin e funksionalitetit të këtyre masave nga autoritetet kompetente. Në arsyetimin e vendimit theksohet se ai është nxjerrë pas konstatimeve të Inspektoratit se në hidrocentralet e inspektuara nuk ishte arritur verifikimi i prurjes së pranueshme ekologjike, gjë që paraqiste rrezik për degradimin e ekosistemeve ujore, humbjen e biodiversitetit dhe shfrytëzimin e pakontrolluar të ujërave. Sipas ministrisë, vendimi synon forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor, mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe garantimin e monitorimit të vazhdueshëm të prurjeve ujore, duke balancuar interesin publik për mbrojtjen e mjedisit me aktivitetin ekonomik të operatorëve të hidrocentraleve[29].

Përmbytjet (Vërshimet)

79. Përmbytjet paraqesin një nga rreziqet natyrore më të shpeshta që lidhen me menaxhimin e resurseve ujore. Ato mund të shkaktohen nga dalja e ujit përtej shtratit të lumenjve, kanaleve dhe trupave të tjerë ujorë ose si pasojë e reshjeve intensive. Në këtë drejtim, Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në nenin 50, paragrafi 3, obligon ministrinë përgjegjëse të monitorojë gjendjen e ujërave, të përcjellë zhvillimin e valëve përmbytëse dhe të sigurojë parashikime afatshkurtra dhe afatgjata për reshjet, para, gjatë dhe pas situatave të përmbytjeve.

80. Ndër format më të zakonshme janë përmbytjet lumore, të cilat ndodhin kur prurjet e ujit tejkalojnë kapacitetin e shtratit të lumit, kryesisht si pasojë e reshjeve intensive ose shkrirjes së shpejtë të borës. Një kategori e veçantë janë përmbytjet e shpejta (flash floods), të cilat zhvillohen brenda një kohe të shkurtër, zakonisht në ujërrjedha të vogla dhe me pjerrtësi të madhe.

81. Një formë tjetër e shpeshtë janë përmbytjet urbane, të cilat prekin zonat e banuara dhe shkaktohen kryesisht nga mungesa ose kapaciteti i pamjaftueshëm i sistemeve të kanalizimit të ujërave atmosferike për të përballuar prurjet e krijuara nga reshjet intensive.

[29]https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2026_5c21638c-77d9-4640-86aa-7a34e5ffa0bb.pdf

82. Megjithëse përmbytjet nuk mund të parandalohen plotësisht, rreziku dhe pasojat e tyre mund të zvogëlohen përmes planifikimit të qëndrueshëm hapësinor, mbrojtjes së ekosistemeve ujore dhe investimeve në infrastrukturën mbrojtëse. Sipas Komisionit Evropian, përmbytjet përbëjnë fatkeqësinë natyrore më të shpeshtë dhe ndër më të kushtueshmet në Evropë, ndërsa ndryshimet klimatike po ndikojnë në rritjen e shpeshtësisë dhe intensitetit të tyre

83. Duke marrë parasysh se që nga viti 1999, Kosova është karakterizuar nga një proces i shpejtë urbanizimi, i cili në shumë raste është zhvilluar pa planifikim të mjaftueshëm hapësinor, andaj si pasojë, janë evidentuar shfrytëzim jo i qëndrueshëm i tokës, ndërtime në zona të ekspozuara ndaj rrezikut nga vërshimet dhe ndërhyrje që kanë ndikuar në degradimin e mjedisit. Njëkohësisht, në një numër të konsiderueshëm të komunave vazhdon të mungojë një rrjet i përshtatshëm dhe i mirëmbajtur i kanalizimit të ujërave atmosferike, gjë që ndikon në rritjen e rrezikut nga përmbytjet. Për më tepër, erozioni i tokës dhe sedimentimi i shtretërve të lumenjve zvogëlojnë kapacitetin e tyre për të përballuar prurjet e larta të ujit, duke rritur ekspozimin e popullsisë, pronës dhe infrastrukturës ndaj rrezikut nga vërshimet.

84. Sipas Raportit të APRL-së të vitit 2021, për Vlerësimin Paraprak të Rrezikut nga Vërshimet për Pellgjet Lumore të Kosovës përmbytjet urbane (pluviale) paraqesin një nga format më të shpeshta të vërshimeve në Kosovë, veçanërisht në zonat urbane gjatë reshjeve intensive të shiut. Këto ngjarje shkaktojnë dëme të konsiderueshme ekonomike, ndërprerje të qarkullimit rrugor dhe vështirësi në funksionimin normal të qyteteve. Raporti vlerëson se një ndër faktorët kryesorë që ndikon në shfaqjen e këtyre përmbytjeve është kapaciteti i pamjaftueshëm dhe gjendja jo e mirë e infrastrukturës së kanalizimit atmosferik, e cila në shumë raste është e vjetruar, e pamjaftueshme ose kërkon rehabilitim dhe investime të konsiderueshme[30].

85. Ndërsa, bazuar në raportin "Ndikimi i Shfrytëzuesve të Rërës dhe Zhavorit në Gjendjen Mjedisore të Lumenjve (AMMK, 2022)", në Kosovë më së shpeshti paraqiten vërshimet e shpejta (flash floods), të cilat shkaktohen nga reshjet intensive të shiut, stuhitë e fuqishme ose nga shkrirja e shpejtë e borës. Këto vërshime zhvillohen brenda një periudhe të shkurtër kohore, karakterizohen nga rritje të menjëhershme të prurjeve ujore dhe paraqesin rrezik të lartë për popullsinë, infrastrukturën, tokat bujqësore dhe aktivitetet ekonomike, veçanërisht në zonat përgjatë lumenjve dhe përrenjve[31].

86. Sipas Raportit të Vërshimeve në Kosovë të ARPL-së, të publikuar në vitin 2023[32], vërshimet në Kosovë janë rezultat i kombinimit të faktorëve natyrorë dhe atyre të shkaktuar nga njeriu. Nga aspekti natyror, territori i Kosovës karakterizohet nga fusha të rrethuara me male, të cilat mundësojnë rrjedhje të shpejtë të ujërave dhe krijimin e prurjeve të mëdha gjatë reshjeve intensive. Për më tepër, shumica e lumenjve nuk kanë shtretër me kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar prurjet maksimale, ndërsa karakteristikat morfologjike të terrenit favorizojnë zhvillimin e vërshimeve të shpejta dhe me shtrirje të gjerë. Reshjet e dendura dhe të pandërprera të shiut gjatë muajve nëntor

[30] *Raporti i Vlerësimit Paraprak të Rrezikut nga Vërshimet për Pellgjet e Lumore të Kosovës*, janar 2021.

[31] Ndikimi i Shfrytëzuesve të Rërës dhe Zhavorit në Gjendjen Mjedisore të Lumenjve (AMMK, 2022) https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20per%20gjendjen%20e%20lumenjeve%202022%20(alb).pdf

[32] https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_ef1c6b78-a8d9-4430-b235-722db746559d.pdf

2022 dhe janar 2023 u identifikuan si shkaktari kryesor i situatave të fundit të vërshimeve në vend.

87. Raporti thekson se, përveç kushteve natyrore, në përkeqësimin e situatës ndikojnë edhe faktorë antropogjenë. Shtretërit e lumenjve në shumë raste janë të cekët, të parregulluar dhe të pamirëmbajtur, ndërsa hedhja e mbeturinave në lumenj, bllokimi i kanaleve kulluese, prerja e drurëve përgjatë lumenjve, si dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve e zvogëlojnë kapacitetin e tyre për të përçuar ujërat. Gjithashtu, zgjerimi i vendbanimeve, zhvillimi i infrastrukturës dhe aktivitetet ekonomike në zonat me rrezik nga vërshimet kanë rritur ekspozimin e popullsisë dhe pronës ndaj këtij rreziku.

88. Për sa i përket shtrirjes gjeografike, raporti evidenton se vërshimet më të mëdha janë regjistruar kryesisht në pellgjet lumore të Drinit të Bardhë dhe Ibrit, të cilat u prekën rëndë pas reshjeve intensive të janarit 2023. Ndër komunat më të goditura përmenden Mitrovica, Mitrovica e Veriut, Skenderaj, Klina, Istogu, Peja, Deçani, Podujeva, Drenasi, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, ku u raportuan përmbytje të vendbanimeve, tokave bujqësore, bizneseve, infrastrukturës rrugore dhe urave. Në veçanti, në Komunën e Skenderajt si shkaktarë kryesorë të vërshimeve u identifikuan Lumi Klina, Lumi Qubrel dhe Përroi i Keq, ndërsa në Mitrovicë dëme të konsiderueshme u shkaktuan nga dalja e Lumit Lushta nga shtrati.

89. Po ashtu, sipas këtij raporti, IHMK-ja realizon paralajmërimin e hershëm për rrezikun nga vërshimet përmes monitorimit të vazhdueshëm të reshjeve dhe niveleve të ujërave, duke përdorur rrjetin e stacioneve automatike meteorologjike dhe hidrologjike, si dhe modele parashikuese hidrologjike. Paralajmërimet përditësohen sipas zhvillimit të situatës hidrometeorologjike dhe u shpërndahen institucioneve përgjegjëse dhe publikut. Për lumenjtë kryesorë të Kosovës dhe profilet kryesore hidrometrike, IHKM-ja ka përcaktuar pragjet e vërshimeve, të cilat janë të integruara në sistemin e paralajmërimit të hershëm. Ky sistem mbështetet në pajisje senzorike dhe telemetrike që mundësojnë monitorimin e niveleve të ujit dhe transmetimin e të dhënave pothuajse në kohë reale, duke lehtësuar identifikimin dhe paralajmërimin e hershëm për rrezikun nga vërshimet.

90. Në kuadër të masave jostrukturore për mbrojtjen nga vërshimet, vërehet se vendi ka harmonizuar legjislacionin me Direktivën 2007/60/EC[33], përmes Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave, i cili përcakton procesin e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet përmes tri fazave: vlerësimit paraprak të rrezikut, hartimit të Hartave të Rrezikshmërisë dhe Hartave të Rrezikut nga Vërshimet, si dhe hartimit të Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet. Në zbatim të kësaj, në janar 2021 u hartua Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Vërshimet, ndërsa gjatë vitit 2024 u përfunduan dhe u prezantuan Hartat e Rrezikshmërisë dhe Hartat e Rrezikut nga Vërshimet. Sipas informatave të ofruara nga ARPL-ja më 30 korrik 2026, ndërkohë është përfunduar edhe Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet.

91. Sipas dokumentit “Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Vërshimet për Pellgjet Lumore në Kosovë”, në vend janë identifikuar 16.668 amvisëri të ekspozuara ndaj rrezikut nga përmbytjet, prej të cilave 15.912 konsiderohen në rrezik të jashtëzakonshëm. Numri më i madh i amvisërive të rrezikuara është evidentuar në pellgun e Ibrit (9.130), pasuar nga

[33] Direktiva 2007/60/EC. 2007 - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32007L0060

pellgu i Moravës së Binçës (4.474), pellgu i Lepencit (1.746) dhe pellgu i Drinit të Bardhë me Pllavën (1.278).

92. Bazuar në raportimet mediale lidhur me vërshimet në vend, për sa u përket vërshimeve të janarit 2023, mediat raportuan se reshjet intensive prekën një numër të madh komunash, përfshirë Mitrovicën, Skenderajn, Klinën, Istogun, Pejën dhe zona të tjera të vendit, duke shkaktuar përmbytje të banesave, tokave bujqësore, rrugëve dhe infrastrukturës publike, si dhe evakuimin e qytetarëve nga zonat e rrezikuara. Institucionet shtetërore ngritën nivelin e gatishmërisë dhe mobilizuan Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Policinë e Kosovës dhe njësitë e zjarrfikjes për menaxhimin e situatës[34].

93. Po ashtu, mediat vendore raportuan se vërshimet e 24 qershorit 2023 në Komunën e Pejës përbëjnë ngjarjen më tragjike të shkaktuar nga përmbytjet në Kosovë gjatë dekadës së fundit. Sipas raportimeve të publikuara nga Koha, Telegrafi dhe Gazeta Express, reshjet e rrëmbyeshme shkaktuan përmbytje të menjëhershme në lagjen "Asllan Qeshme", në Pejë, ku ujërat depërtuan në banesa dhe rrëmbyen një grua dhe djalin e saj pesëvjeçar dhe si pasoj të dy humbën jetën. Përveç humbjes së dy jetëve, vërshimet shkaktuan dëme të konsiderueshme në banesa, biznese, automjete, ekonomi familjare, bujqësi dhe infrastrukturë publike, ndërsa në operacionet e kërkim-shpëtimit u angazhuan Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe autoritetet komunale[35].

94. Po ashtu, vërshimet e ndodhura gjatë periudhës 6 deri 11 janar 2026 kanë pasuar me pasoja të rënda nga përmbytjet në Kosovë. Sipas raportimeve të publikuara nga Koha dhe Telegrafi, reshjet intensive shkaktuan vërshime në më shumë se dhjetë komuna, përfshirë Gjakovën, Mitrovicën, Vushtrrinë, Skenderajn, Drenasin, Malishevën, Rahovecin, Klinën dhe Fushë Kosovën. Si pasojë e situatës, u evakuuan dhjetëra familje, veçanërisht në Komunën e Gjakovës, ndërsa u përmbytën qindra shtëpi, oborre, rrugë, sipërfaqe bujqësore dhe objekte afariste. Raportimet po ashtu evidentojnë ndërprerje të furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike në disa zona të prekura, si dhe angazhimin e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, njësive zjarrfikëse dhe autoriteteve komunale në operacionet e shpëtimit, evakuimit dhe menaxhimit të situatës. Më tej, sipas raportimeve të mëvonshme të medias Koha[36], vlerësimet e komunave të prekura tregojnë se dëmet ekonomike të shkaktuara nga këto vërshime arrijnë në rreth 8 milionë euro, duke dëshmuar ndikimin e konsiderueshëm të kësaj fatkeqësie natyrore mbi qytetarët, ekonominë lokale dhe infrastrukturën publike[37].

95. Duke pasur parasysh nivelin e rrezikut nga vërshimet, meqë Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet është finalizuar, MMPHI-ja, në bashkëpunim me Autoritetin e Rajonit të Pellgjeve Lumore, IHMK-në, komunat dhe institucionet e tjera përgjegjëse, duhet të sigurojë zbatimin e masave për parandalimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe reagimin

[34] https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_9dcc8b4b-324f-4f44-a894-918c29d7558d.pdf?fbclid=IwAR3ExuFM15K4lOl1Kn54niuboWzqHZq1GAmq31P08kMS1Mld8wb-y6DkgjQ&utm

[35] https://www.koha.net/arberi/kfor-i-shpreh-ngushellime-per-vdekjen-e-dy-qytetareve-nga-permbytjet-ne-peje; https://telegrafi.com/amp/permbledhje-e-detajuar-e-gjithe-asaj-qe-ndodhi-gjate-dhe-pas-vershimeve-ne-peje-2672138470?utm

[36] https://www.koha.net/arberi/vershimet-ne-prishtine-me-pak-deme-se-me-2023

[37] https://telegrafi.com/vershime-dhe-evakuime-ne-disa-komuna-ne-kosove-ame-publikon-raportin-e-fundit-nga-reshjet-dhe-intervenimet/

ndaj vërshimeve, në përputhje me kompetencat dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave. Këto masa do të duhej të përfshinin:

- Emërimi dhe funksionalizimi i Koordinatorit Kombëtar për Vërshime, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 19/2015.
- Vlerësimi i shkaqeve dhe pasojave të vërshimeve, si bazë për planifikimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse.
- Zbatimi i masave të rregullta dhe emergjente për mbrojtje nga vërshimet, përfshirë mirëmbajtjen e ujërrjedhave dhe largimin e pengesave që ndikojnë në rrjedhën e ujit.
- Hartimi dhe zbatimi i programeve vjetore për mirëmbajtjen e ujërrjedhave dhe sistemeve të kanalizimit atmosferik, sipas kompetencave të autoriteteve përgjegjëse.
- Hartimi i standardeve teknike për projektimin dhe rregullimin e ujërrjedhave.
- Hartimi i standardeve teknike për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimit të ujërave atmosferike.

Zbatimi i masave të rregullta për mbrojtje nga vërshimet

96. MMPHI-ja, sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave, ka përgjegjësi kyçe në planifikimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e mbrojtjes nga vërshimet. Në kuadër të këtyre përgjegjësive, Ministria: i) emëron Koordinatorin Kombëtar për Vërshime; ii) miraton Planin për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet; ndërsa përmes Inspektoratit të Ujërave siguron iii) zbatimin e ndalesave dhe kufizimeve për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave. Përmes Koordinatorit Kombëtar për Vërshime, Ministria gjithashtu iv) monitoron dhe koordinon zbatimin e masave mbrojtëse me koordinatorët komunalë dhe institucionet përgjegjëse, v) organizon bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në mbrojtjen nga vërshimet, vi) mbështet zbatimin e obligimeve ndërshtetërore dhe vii) shqyrton dhe jep pëlqim për realizimin e punimeve emergjente në shtretërit e lumenjve dhe në objektet e infrastrukturës ujore.
97. ARPL-ja, sipas të njëjtit udhëzim administrativ, është institucioni përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga vërshimet në pellgjet lumore jashtë zonave urbane. Në këtë drejtim, ARPL-ja: i) kryen vlerësimin paraprak të rrezikut nga vërshimet dhe identifikon zonat me rrezikshmëri të lartë; ii) harton hartat e rrezikut dhe Planin për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet; iii) përgatit planet operative për mbrojtjen nga vërshimet jashtë zonave urbane në bashkëpunim me Agjencinë për Menaxhim Emergjent; iv) planifikon dhe zbaton punimet për ndërtimin, rindërtimin dhe mbindërtimin e objekteve të infrastrukturës ujore dhe objekteve shkarkuese për evakuimin e ujërave të mëdha; v) planifikon dhe realizon mirëmbajtjen e ujërrjedhave natyrore dhe artificiale, objekteve rregulluese, mbrojtëse dhe shkarkuese; vi) kryen kontrollin e rregullt të gjendjes së këtyre objekteve; si dhe vii) mbështet komunat në hartimin e planeve operative dhe koordinon aktivitetet me institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen nga vërshimet.
98. IHMK-ja është përgjegjëse për monitorimin dhe ofrimin e të dhënave hidrometeorologjike, që shërbejnë si bazë për sistemin e mbrojtjes nga vërshimet. Në këtë kuadër, IHMK-ja: i) monitoron në mënyrë të vazhdueshme dukuritë hidrologjike dhe

meteorologjike; ii) mat prurjet e ujërave dhe prurjet e mëdha; iii) harton raporte për sasinë dhe llojin e reshjeve; iv) realizon parashikimin e motit dhe reshjeve; v) publikon dhe shpërndan të dhënat tek autoritetet kompetente; vi) përgatit analiza statistikore mbi prurjet e ujërave; dhe vii) siguron ndërlidhjen e sistemit të tij informativ me Autoritetin dhe Agjencinë për Menaxhim Emergjent.

99. Komunat, sipas nenit 13 të Udhëzimit Administrativ nr. 19/2015, janë përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e mbrojtjes nga vërshimet brenda zonave urbane të territorit të tyre. Për këtë qëllim, ato: i) hartojnë planet operative emergjente komunale; ii) planifikojnë dhe zbatojnë sistemet e monitorimit të ujërave dhe mbrojtjes nga vërshimet; iii) monitorojnë të dhënat hidrologjike dhe meteorologjike, mirëmbajnë sistemet informative dhe hartojnë modele hidrologjike e plane për menaxhimin e rrezikut; iv) planifikojnë dhe realizojnë ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ujore, objekteve rregulluese, mbrojtëse dhe shkarkuese; v) sigurojnë hapësira retencioni, pajisje, materiale dhe resurse njerëzore për mbrojtje nga vërshimet; vi) njoftojnë me kohë qytetarët dhe institucionet për rrezikun nga vërshimet dhe trajnojnë personelin përgjegjës; si dhe vii) harmonizojnë planifikimin hapësinor me planet për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet, në koordinim me organet kompetente të mbrojtjes dhe reagimit emergjent.

100. Institucionet e tjera, përfshirë ministritë e linjës, Agjencinë për Menaxhim Emergjent, ndërmarrjet publike, shoqatat dhe organizatat e tjera përgjegjëse, sipas nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 19/2015, janë të obliguara që, brenda kompetencave të tyre, i) të planifikojnë dhe zbatojnë masat për mbrojtjen nga vërshimet; ii) të veprojnë në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, aktet nënligjore për mbrojtjen emergjente dhe Planin e Reagimit Kombëtar; si dhe iii) të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet me institucionet përgjegjëse për parandalimin, menaxhimin dhe reagimin ndaj vërshimeve.

101. Duke pasur parasysh se vërshimet paraqesin një nga rreziqet natyrore më serioze në vend, mbrojtja efektive nga kjo dukuri varet nga zbatimi i plotë dhe në kohë i përgjegjësive ligjore nga të gjitha institucionet kompetente. Parandalimi i vërshimeve nuk mund të arrihet vetëm përmes reagimit gjatë emergjencave, por kërkon planifikim afatgjatë, investime të vazhdueshme në infrastrukturën ujore, monitorim dhe mirëmbajtje sistematike të ujërrjedhave, si dhe funksionimin e mekanizmave të paralajmërimit të hershëm. Avokati i Popullit e vlerëson si të rëndësishëm koordinimin e vazhdueshëm ndërinstitucional dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve qendrore, lokale dhe institucioneve teknike, në mënyrë që masat parandaluese dhe reagimi ndaj rrezikut të jenë të harmonizuara dhe efektive. Vetëm përmes një qasjeje të tillë të koordinuar dhe zbatimit konsekuent të obligimeve ligjore mund të zvogëlohet rreziku për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, të mbrohet infrastruktura publike dhe private, si dhe të minimizohen dëmet ekonomike dhe mjedisore të shkaktuara nga vërshimet.

Cilësia e ujit të pijshëm në vend

102. Sipas Udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) për Cilësinë e Ujit të Pijshëm, qasja në ujë të pijshëm të sigurt përbën parakusht themelor për mbrojtjen e shëndetit publik dhe realizimin efektiv të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, cilësia e ujit të pijshëm paraqet një ndër treguesit kryesorë të shëndetit dhe mirëqenies së popullsisë, ndërsa sigurimi i ujit të sigurt, të mjaftueshëm dhe të qasshëm përbën element të rëndësishëm të politikave të shëndetit publik dhe të zhvillimit të qëndrueshëm. OBSh-

ja, në këtë drejtim, rekomandon që mbrojtja e cilësisë së ujit të mbështetet në një qasje të integruar të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut përgjatë tërë zinxhirit të furnizimit, nga burimi deri te konsumatori.

103. Në këtë kontekst, Agjenda 2030 e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, të cilën Kosova e ka miratuar në vitin 2018, përmes Synimit 6 (SDG 6), përcakton objektivin për sigurimin e disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimit për të gjithë. Në veçanti, Caku 6.1 synon që deri në vitin 2030 të arrihet qasje universale dhe e barabartë në ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë. Agjenda 2030 e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, të cilën e ka miratuar edhe Kosova në vitin 2018, ka përcaktuar 17 synime të zhvillimit të qëndrueshëm. Në synimin 6 (SDG 6) të këtij dokumenti thuhet: *"Uji e mirëmban jetën, por uji i pastër dhe i sigurt e përkufizon civilizimin."* Caku i parë në kuadër të këtij synimi (Caku 6.1) është: *"Deri në vitin 2030 të arrihet qasje universale dhe e drejtë në ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë."*

104. Në Republikën e Kosovës, korniza ligjore për sigurimin dhe mbrojtjen e cilësisë së ujit të pijshëm përcaktohet, ndër të tjera, me Ligjin nr. 02/L-78 për Shëndetësinë Publike dhe Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor, përmes të cilit është transpozuar legjislacioni përkatës i Bashkimit Evropian në këtë fushë.

105. Në bazë të Ligjit për Shëndetësinë Publike, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) është autoriteti kompetent për monitorimin, mbikëqyrjen, kontrollin, analizimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Udhëzimi Administrativ nr. 10/2021, ndërkaq, përcakton standardet dhe kërkesat për cilësinë e ujit për konsum njerëzor, përfshirë vlerat parametrike që duhet të përmbushen, procedurat e monitorimit, masat që duhet të ndërmerren në rast të cenimit të cilësisë së ujit, si dhe përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse. Sipas këtij udhëzimi, uji për konsum njerëzor duhet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër dhe të mos përmbajë mikroorganizma, parazitë apo substanca të tjera në përqendrime që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut.

106. Kontrolli dhe mbikëqyrja e cilësisë së ujit të pijshëm realizohen nga IKShPK-ja përmes monitorimit të përputhshmërisë, me qëllim të verifikimit nëse uji që u ofrohet konsumatorëve i përmbush vlerat parametrike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Në rast të konstatimit të mospërputhjes, Qendra e Ujit e IKShPK-së është e obliguar të njoftojë autoritetet përkatëse, përfshirë komunat, Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) dhe furnizuesin e ujit, si dhe të rekomandojë masat e nevojshme korrigjuese, përfshirë, kur është e nevojshme, kufizimin e përdorimit të ujit me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

107. Për sa u përket parametrave radioaktivë, përkatësisht radonit, tritiumit dhe dozës indikative, monitorimi i tyre, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 10/2021, është përgjegjësi e Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AMRrSB). Ky monitorim ka për qëllim vlerësimin nëse prania e substancave radioaktive në ujin e destinuar për konsum njerëzor paraqet rrezik për shëndetin dhe, nëse është e nevojshme, ndërmarrjen e masave korrigjuese për sigurimin e cilësisë së ujit në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

108. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 10/2021 përcakton detyrimin e furnizuesve të ujit, përkatësisht KRU-ve, për hartimin e planeve të sigurisë së ujit, të bazuara në parimin e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut dhe në udhëzuesin e përgatitur nga IKShPK-ja.

Përgjegjësitë ligjore të IKShPK-së në këtë fushë ushtrohen përmes Qendrës së Ujit, e cila ka përgjegjësi për ndërmarrjen e masave të nevojshme për të siguruar që uji i destinuar për konsum njerëzor të jetë i shëndetshëm dhe i pastër.

109. Furnizimi me ujë të pijshëm në Republikën e Kosovës realizohet përmes tri formave kryesore: sistemeve publike të ujësjellësit të administruara nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU); sistemeve publike, kryesisht rurale, që funksionojnë jashtë administrimit të KRU-ve; si dhe burimeve individuale të furnizimit, përfshirë puset dhe burimet natyrore.

Cilësia e ujit të pijshëm në sistemet e menaxhuara nga KRU-të

110. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 2020–2021, mbi 90% e popullsisë[38] furnizohej me ujë nga sistemet publike të ujësjellësit. Sipas të dhënave të përdorura në raport, 79%[39] e popullsisë furnizohej përmes sistemeve publike të menaxhuara nga KRU-të, ndërsa pjesa tjetër përmes sistemeve publike që nuk administroheshin nga KRU-të. Rreth 5% e popullsisë furnizohej nga burime individuale, kryesisht puse.

111. Të dhënat më të fundit të paraqitura në Raportin e Punës të ARRU-së për vitin 2025 tregojnë se shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm ofrohen nga shtatë KRU të licencuara për zonat përkatëse të shërbimit. Megjithatë, mbulimi me shërbime të menaxhuara nga KRU-të nuk përfshin ende të gjitha sistemet publike të furnizimit me ujë. ARRU-ja evidenton se, në zonat e shërbimit të disa KRU-ve, veçanërisht të KRU "Hidroregjioni Jugor", KRU "Bifurkacioni" dhe KRU "Hidromorava", vazhdojnë të funksionojnë sisteme rurale të furnizimit me ujë që nuk janë integruar në strukturën menaxhuese të operatorëve të licencuar. Sipas raportit, kjo gjendje lidhet, ndër të tjera, me refuzimin e disa komuniteteve për integrim dhe me gjendjen e dobët teknike të sistemeve, rehabilitimi i të cilave kërkohet para marrjes së tyre nën menaxhimin e KRU-ve.

112. Për sa i përket cilësisë së ujit të furnizuar përmes sistemeve të menaxhuara nga KRU-të, të dhënat e IKShPK-së tregojnë një shkallë të lartë të përputhshmërisë me standardet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021. Në vitin 2021, 99.16% e mostrave kanë rezultuar në përputhje me parametrat mikrobiologjikë dhe 98.42% me parametrat kimikë. Monitorimi për vitet 2024 dhe 2025, po ashtu, tregon nivel të lartë të përputhshmërisë, përkatësisht 98.7% dhe 98.2% të mostrave të analizuara. Gjatë këtyre dy viteve, mostrat e analizuara për metalet e rënda kanë rezultuar brenda kufijve të lejuar, ndërsa mospërputhjet e evidentuara kanë qenë kryesisht të natyrës mikrobiologjike dhe kimike.

113. Megjithatë, përkundër nivelit përgjithësisht të lartë të përputhshmërisë, gjatë vitit 2025 është evidentuar përsëri rritja sezonale e përqendrimit të manganit në Liqenin e Badovcit. Në përgjigjen e datës 29 shtator 2025, IKShPK-ja e ka njoftuar Avokatin e Popullit se kjo dukuri zakonisht paraqitet gjatë ndërrimit të stinëve. Nga Impianti i Trajtimit të Ujit në

[38] Sipas raportit *Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020-2021*, të Agjencisë për Statistika të Kosovës - https://ask.rks-gov.net/media/6987/statistikat-e-ujrave-2020-2021.pdf

[39] Sipas *Raportit Vjetor të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit për vitin 2021*, të hartuar dhe publikuar nga ARRU - http://www.arru-rks.org/assets/cms/upload/RaportiVjetoriPerformancesOfruesveteSherbimit_05.09.2022.pdf

Badovc furnizohen banorët e Zonës PR03, që përfshin Prishtinën, Hajvalinë, Çagllavicën dhe Graçanicën. Sipas IKShPK-së, gjatë vitit 2025 përqendrimet e manganit filluan të rriteshin në fund të muajit gusht dhe, gjatë dy javëve të para të shtatorit, tejkaluan standardin shëndetësor të OBSh-së prej 0.3 mg/L, për të shënuar më pas rënie të ndjeshme. Në këto rrethana, IKShPK-ja rekomandoi vazhdimin e monitorimit të të gjitha fazave të trajtimit dhe shpëlarjen e rregullt të rrjetit shpërndarës.

114. Raporti Vjetor i Punës i IKShPK-së për vitin 2025 vlerëson se cilësia e ujit të pijshëm në Kosovë, në përgjithësi, ka qenë e mirë. Gjatë monitorimit të rregullt të 47 zonave të furnizimit të menaxhuara nga shtatë KRU-të janë analizuar 12.620 mostra, prej të cilave rreth 98% kanë rezultuar në përputhje me standardet dhe rreth 2% jashtë vlerave të përcaktuara. Monitorimi ka përfshirë parametrat mikrobiologjikë, analizat bazike fiziko-kimike, si dhe analizat periodike për metalet e rënda, pesticidet, karbonin total organik dhe trihalometanet.

115. Megjithatë, rezultatet tregojnë dallime ndërmjet rajoneve. Përqindjen më të lartë të mostrave jashtë standardeve e kanë shënuar rajoni i Ferizajt, me 4.5%, dhe ai i Pejës, me 4.4%, të pasuara nga Mitrovica me 2.8% dhe Prishtina me 1.09%, ndërsa Gjilani ka regjistruar nivelin më të ulët, me 0.1%. Rrjedhimisht, ndonëse të dhënat e përgjithshme tregojnë nivel të lartë të përputhshmërisë, dallimet rajonale evidentojnë nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe masa të synuara në zonat ku mospërputhjet paraqiten më shpesh.

116. Përveç monitorimit të rregullt, IKShPK-ja ka realizuar 2.497 analiza shtesë të llojeve të ndryshme të ujit jashtë planit të monitorimit, prej të cilave 2.96% kanë rezultuar jashtë standardeve. Problemet më të theksuara janë evidentuar te burimet individuale të furnizimit, veçanërisht puset, bunarët dhe shpimet, ku 30.06% e mostrave kanë rezultuar jashtë standardeve mikrobiologjike. Këto të dhëna tregojnë se shkalla e rrezikut është dukshëm më e lartë te burimet individuale sesa te sistemet publike të administruara nga KRU-të.

117. Në aspektin fiziko-kimik, nga 1.919 analiza bazike, 231 mostra, përkatësisht 12.03%, kanë rezultuar jashtë standardeve, ndërsa 272 analizat periodike, të cilat kanë përfshirë metalet e rënda dhe substanca të tjera prioritare, kanë rezultuar në përputhje të plotë me standardet. Në kuadër të monitorimit shtesë të fenomenit të manganit në Liqenin e Badovcit janë analizuar 258 mostra, prej të cilave 145, ose 56.2%, kanë rezultuar me përqendrime të manganit mbi kufijtë e lejuar. Kjo situatë nënvizon rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të burimeve sipërfaqësore dhe të ndërmarrjes së masave parandaluese dhe korrigjuese për garantimin e sigurisë së furnizimit.

118. Sipas Raportit të Punës së ARRU-së për vitin 2025, të dhënat për cilësinë e ujit të furnizuar nga të gjitha KRU-të, të raportuara nga Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik në kuadër të IKShPK-së, tregojnë një nivel përgjithësisht të lartë të përputhshmërisë me standardet. Në nivel të sektorit, përshtatshmëria bakteriologjike e ujit ka qenë 99.5%, ndërsa ajo fiziko-kimike 98.6%. Sipas KRU-ve, përputhshmëria fiziko-kimike/bakteriologjike ka qenë: KRU “Prishtina” 96.9%/100%; KRU “Hidroregjioni Jugor” 99.3%/99%; KRU “Hidrodrini” 97.2%/99.9%; KRU “Mitrovica” 100%/100%; KRU “Gjakova” 100%/100%; KRU “Bifurkacioni” 97.2%/94.3%; dhe KRU “Hidromorava” 100%/100%. Kështu, rezultatet më të ulëta janë evidentuar te KRU “Bifurkacioni”, veçanërisht për sa i përket përputhshmërisë bakteriologjike prej 94.3%,

ndërsa KRU “Mitrovica”, “Gjakova” dhe “Hidromorava” kanë arritur përputhshmëri të plotë në të dy kategoritë e testimit[40].

119. Në të njëjtën kohë, KRU “Prishtina” ka identifikuar një varg sfidash që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit, përfshirë humbjet teknike dhe administrative të ujit, stabilitetin e burimeve ujore, ndryshimet klimatike, menaxhimin e krizave gjatë thatësirave, vërshimeve dhe periudhave me turbullirë të lartë, infrastrukturën e vjetruar, koston e kimikateve dhe nevojën për modernizimin e kapaciteteve laboratorike. Në këtë kuadër, edhe hartimi dhe zbatimi i planeve të sigurisë së ujit është identifikuar ndër çështjet që kërkojnë trajtim të mëtejshëm.

Sistemet publike të furnizimit që nuk menaxhohen nga KRU-të

120. Për dallim nga sistemet e administruara nga KRU-të, sfida më të theksuara në aspektin e sigurisë dhe kontrollit të cilësisë evidentohen te sistemet publike të furnizimit që funksionojnë jashtë administrimit të operatorëve të licencuar. Këto përfshijnë kryesisht ujësjellës ruralë në një numër komunash, përfshirë Dragashin, Prizrenin, Novobërdën, Shtërpcën, Kllokotin, Parteshin, Kamenicën, Gjilanin, Ferizajn dhe Kaçanikun.

121. Meqenëse këto sisteme nuk administrohen nga furnizues të licencuar, nënkupton se ato nuk i nënshtrohen të njëjtit mekanizëm të organizuar të menaxhimit dhe kontrollit që zbatohet për sistemet e KRU-ve. Për pasojë, informacionet mbi cilësinë e ujit të furnizuar përmes tyre mbeten të kufizuara. Për më tepër, në shumë raste, burimet që shfrytëzohen për furnizim nuk kanë zona të përcaktuara të mbrojtjes sanitare, duke rritur ekspozimin e tyre ndaj ndotjes dhe duke vështirësuar zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.

122. Mungesa e një sistemi të organizuar të administrimit, monitorimit të vazhdueshëm dhe mbrojtjes efektive të burimeve ujore paraqet një sfidë të rëndësishme për garantimin e sigurisë së ujit të pijshëm që furnizohet nga këto sisteme.

123. Sipas Planit Strategjik 2024–2026 të ARRU-së, rezulton se zgjerimi i mbulueshmërisë së shërbimeve të ujit është identifikuar si çështje prioritare, veçanërisht përmes integrimit të sistemeve rurale dhe urbane që aktualisht operohen jashtë strukturave të KRU-ve të licencuara. ARRU-ja ka vlerësuar se këto sisteme vazhdojnë të degradohen për shkak të operimit dhe mirëmbajtjes joprofesionale dhe ka përcaktuar si objektiv specifik mbështetjen e integrimit të tyre dhe zgjerimin e zonave të shërbimit. Rezultati i synuar për periudhën 2024–2026 është funksionalizimi i sistemeve dhe rritja e mbulueshmërisë me shërbime të ujit dhe kanalizimit. Si sfida kryesore identifikohen mosintegrimi i sistemeve rurale, operimi nga operatorë të palicencuar, degradimi i infrastrukturës, mungesa e koordinimit ndërinstitucional, infrastruktura e amortizuar, ndryshimet klimatike dhe kapacitetet e kufizuara të inspektimit. Po ashtu, vërehet se ARRU-ja ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse që grantet qeveritare për KRU-të të orientohen drejt rehabilitimit të sistemeve ekzistuese rurale, me qëllim të krijimit të kushteve teknike për integrimin e tyre nën menaxhimin e operatorëve të licencuar dhe parandalimin e degradimit të mëtejshëm të infrastrukturës[41].

Furnizimi nga burimet individuale

[40] Raporti Vjetor i vitit 2025 i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARrU).

[41] Plani Strategjik i ARrU-së 2024-2026: https://arru-rks.org/wp-content/uploads/2025/12/Plani-Strategjik-2024-2026.pdf

124. Një shkallë më e lartë e cenueshmërisë në aspektin e sigurisë së ujit paraqitet te popullsia që furnizohet nga burimet individuale, përfshirë puset dhe burimet natyrore. Sipas të dhënave të përdorura në këtë raport, kjo kategori përbën rreth 5% të popullsisë. Puset nga të cilat furnizohet kjo kategori e popullsisë janë, në shumë raste, të cekëta dhe të pambrojtura nga ndotësit që depërtojnë nga sipërfaqja e tokës, përfshirë ndotësit organikë dhe inorganikë.

125. Kjo gjendje konfirmohet edhe nga të dhënat e IKShPK-së për vitin 2025, sipas të cilave 30.06% e mostrave të marra nga puset, bunarët dhe shpimet në kuadër të analizave shtesë kanë rezultuar jashtë standardeve mikrobiologjike. Për dallim nga sistemet publike të KRU-ve, uji nga burimet individuale nuk i nënshtrohet një sistemi të rregullt dhe gjithëpërfshirës të monitorimit, ndërsa analizimi i tij shpesh varet nga iniciativa e vetë shfrytëzuesit.

126. Avokati i Popullit konsideron se, dallimi i konsiderueshëm ndërmjet nivelit të kontrollit dhe përputhshmërisë së ujit në sistemet e menaxhuara nga KRU-të dhe gjendjes së burimeve individuale të sistemeve të pamenaxhuara nga operatorët e licencuar kërkon vëmendje të shtuar institucionale. Në këtë drejtim, zgjerimi i sistemeve publike të furnizimit në zonat që ende nuk mbulohen prej tyre, rehabilitimi dhe integrimi i sistemeve rurale, si dhe krijimi i mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes së cilësisë së ujit nga burimet individuale paraqiten si masa të rëndësishme për zvogëlimin e rrezikut dhe garantimin e qasjes së barabartë në ujë të sigurt.

Mbrojta e burimeve të ujit të pijshëm

127. Avokati i Popullit vëren se sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm nuk mund të kufizohet vetëm në kontrollin e ujit në pikën e konsumit. Mbrojtja e burimeve ujore, qofshin ato sipërfaqësore apo nëntokësore, përbën një komponent thelbësor të sistemit të sigurisë së ujit, pasi parandalimi i ndotjes në burim zvogëlon rrezikun për shëndetin publik dhe nevojën për ndërhyrje korrigjuese në fazat e mëvonshme të trajtimit.

128. Korniza ligjore për mbrojtjen e burimeve që përdoren për furnizim me ujë të pijshëm përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit[42]. Në veçanti, neni 66, paragrafi 2, i Ligjit për Ujërat përcakton bazën për rregullimin e zonave të mbrojtura sanitare.

129. Në zbatim të kësaj baze ligjore, Udhëzimi Administrativ nr. 15/2017 përcakton kriteret për delimitimin e zonave të mbrojtura sanitare dhe masat që duhet të zbatohen për mbrojtjen e burimeve të destinuara për konsum njerëzor. Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore organizohet përmes tri zonave të mbrojtjes sanitare (Zona I, Zona II dhe Zona III), për të cilat përcaktohen kufizime dhe ndalesa të aktiviteteve që mund të cenojnë cilësinë e burimeve ujore.

130. Sipas të dhënave të Sistemit Informativ Ujor, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë tridhjetë e katër (34) vendime për përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe masave mbrojtëse për burimet ujore që shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm[43].

[42] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15796

[43]Sipas Sistemit Informativ Ujor (SIU) ueb-faqja: https://siu.rks-gov.net/About/WaterManagementDivision

131. Sipas këtyre vendimeve, MMPHI-ja është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të masave mbrojtëse, ndërsa KRU-të kanë përgjegjësi për zbatimin e vendimeve dhe mirëmbajtjen e zonave të para dhe të dyta të mbrojtjes. KRU-të, gjithashtu, kanë detyrimin të raportojnë në baza vjetore pranë Ministrisë lidhur me zbatimin e masave përkatëse.

132. Duke iu referuar Rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Planit të Veprimit 2023-2025, në kuadër të Objektivit Specifik 3.8 - Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm - janë përcaktuar caqe konkrete për zgjerimin e mbrojtjes së burimeve ujore që shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm. Strategjia thekson se mbrojtja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore realizohet përmes përcaktimit të zonave të mbrojtura sanitare dhe vendosjes së masave kufizuese për aktivitetet që mund të shkaktojnë ndotjen e tyre. Në këtë drejtim, si tregues kryesor është përcaktuar numri i burimeve të ujit, për të cilat Qeveria miraton vendime për shpalljen e zonave të mbrojtura. Strategjia ka vendosur si pikënisje 35 burime me zona të mbrojtura, ndërsa ka synuar rritjen e këtij numri në 40 burime deri në vitin 2025 dhe në 45 burime deri në vitin 2027[44].

133. Megjithatë, nga informacionet e paraqitura në dokumentet e shqyrtuara nuk rezulton se ekziston raportim i plotë dhe sistematik mbi shkallën e zbatimit të masave të përcaktuara për zonat e mbrojtura sanitare. Në veçanti, nuk janë identifikuar të dhëna të mjaftueshme që do të mundësonin vlerësimin e zbatimit të plotë të masave mbrojtëse në zonat e Liqenit të Badovcit dhe Batllavës, përfshirë kufizimin e transportit të materieve të rrezikshme, kontrollin e aktiviteteve potencialisht ndotëse dhe vendosjen e sinjalistikës përkatëse.

134. Avokati i Popullit vëren se ekzistenca formale e vendimeve për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare, në vetvete, nuk është e mjaftueshme për garantimin e mbrojtjes efektive të burimeve ujore. Efektiviteti i këtij mekanizmi varet nga zbatimi praktik i kufizimeve dhe masave të përcaktuara, mbikëqyrja e vazhdueshme, koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

135. Në këtë aspekt, zbatimi i masave të përcaktuara me vendimet e Qeverisë kërkon investime financiare dhe kapacitete institucionale, përfshirë realizimin e hulumtimeve, hartimin e projekteve, zhvillimin e procedurave administrative, zbatimin e masave mbrojtëse dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Megjithatë, nga dokumentet e shqyrtuara nuk është identifikuar një vlerësim gjithëpërfshirës i kostove të nevojshme për zbatimin e këtyre masave, qoftë në nivel kombëtar apo në nivel të KRU-ve.

136. Po ashtu, ndonëse Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025 kanë përcaktuar masa dhe caqe konkrete për mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm, nga dokumentet e shqyrtuara nuk rezulton të jenë publikuar të dhëna të mjaftueshme që mundësojnë vlerësimin e shkallës së realizimit të këtyre caqeve.

137. Në këto rrethana, sigurimi efektiv i ujit të pijshëm të sigurt kërkon jo vetëm vazhdimin e monitorimit të cilësisë së ujit në sistemet e licencuara, por edhe avancimin e integrimit të sistemeve rurale, zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime të rregulluara, forcimin e mbikëqyrjes së burimeve individuale, zbatimin efektiv të zonave të mbrojtura sanitare dhe raportimin e rregullt mbi realizimin e objektivave strategjike. Një qasje e tillë është e nevojshme për të siguruar që standardet ligjore për cilësinë e ujit të mos mbeten vetëm

[44]Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Planit të Veprimit 2023–2025 https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_d8a77e4b-0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf?

kërkesa formale, por të rezultojnë në mbrojtje efektive dhe të barabartë të shëndetit dhe sigurisë së të gjithë konsumatorëve.

Përgjegjësitë komunale

138. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Ujërat e Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, komunat kanë përgjegjësi të rëndësishme në mbrojtjen, menaxhimin dhe trajtimin e ujërave në nivel lokal. Në kuadër të kompetencave të tyre vetjake, ato janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizimit, drenazhimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, si dhe për planifikimin urban e rural në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e resurseve ujore. Gjithashtu, komunat zbatojnë legjislacionin mjedisor dhe atë të ujërave, ushtrojnë mbikëqyrje inspektuese në territorin e tyre, hartojnë dhe miratojnë plane lokale për mbrojtjen e mjedisit, bashkëpunojnë me institucionet qendrore në zbatimin e politikave dhe masave për mbrojtjen e ujërave, si dhe sigurojnë informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

139. Sipas Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027[45], vlerësohet se komunat vazhdojnë të përballen me sfida të shumta në mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve ujore, të cilat ndikojnë në cilësinë e ujërave, sigurinë e furnizimit me ujë dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndër sfidat kryesore identifikohen mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme për kanalizim dhe trajtimin e ujërave të ndotura, shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim në lumenj, menaxhimi jo i plotë i sistemeve rurale të ujësjellësit, humbjet e mëdha të ujit në rrjetet e furnizimit, si dhe mbulueshmëria ende jo e plotë me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit. Strategjia thekson se këto mangësi vazhdojnë të ushtrojnë presion të drejtpërdrejtë mbi trupat ujorë dhe paraqesin pengesë për arritjen e standardeve të kërkuara të mbrojtjes së ujërave.

140. Në aspektin e ndotjes, Strategjia evidenton se lumenjtë vazhdojnë të dëmtohen nga shkarkimet komunale të ujërave të patrajtuara, hedhja e mbeturinave në rrjedhat ujore, degradimi i shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i pakontrolluar i aluvioneve, si dhe mungesa e monitorimit dhe kontrollit efektiv ndaj ndotësve. Gjithashtu theksohet se monitorimi biologjik i ujërave, monitorimi i substancave prioritare ndotëse dhe disponueshmëria e të dhënave për cilësinë dhe sasinë e ujërave mbeten të pamjaftueshme për planifikim dhe vendimmarrje efektive.

141. Strategjia vë në dukje gjithashtu mangësi të konsiderueshme në kapacitetet institucionale në nivel lokal. Në veçanti, konstatohet mungesa e inspektorëve komunalë të autorizuar për ujërat, kapacitete të kufizuara profesionale për mbikëqyrjen e ndotjes, kontrollin e shfrytëzimit të ujërave dhe zbatimin e legjislacionit. Po ashtu, komunat përballen me mungesë të ekspertizës për trajtimin e erozionit, mbrojtjen e lumenjve dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet, ndërsa koordinimi ndërinstitucional kërkon fuqizim të mëtejshëm.

142. Sipas raportit të ARPL-së "*Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Kosovë - Raport i Përkohshëm për Konsultim Publik*"[46], i publikuar në mars 2026, dhe sipas

[45]https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_d8a77e4b-0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf?

[46]*ARPL: "Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Kosovë - Raport i Përkohshëm për Konsultim Publik"*[46], mars 2026: https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DivisionDocs/2026_602b0113-58d8-4de0-810e-5ce2f9ab7ee7.pdf

Raportit Vjetor të AMMK-së për gjendjen e mjedisit për vitin 2024[47], komunat në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të konsiderueshme në menaxhimin e resurseve ujore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujërave, sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbrojtjen nga vërshimet. Raportet e institucioneve përgjegjëse evidentojnë se një pjesë e madhe e komunave ende nuk kanë infrastrukturë të mjaftueshme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, për pasojë shumica e ujërave të ndotura vazhdojnë të shkarkohen pa trajtim në lumenj dhe përrenj, duke përkeqësuar gjendjen e ujërave sipërfaqësore.

143. Një sfidë tjetër e theksuar është infrastruktura e pamjaftueshme e kanalizimeve, kolektorëve dhe sistemeve të drenazhimit, veçanërisht në zonat urbane dhe rurale që kanë përjetuar zhvillim të shpejtë. Kjo ka ndikuar në rritjen e rrezikut nga vërshimet, sidomos gjatë reshjeve intensive, ndërsa kapacitetet ekzistuese për largimin e ujërave atmosferike në shumë komuna rezultojnë të pamjaftueshme. Raporti për vërshimet tregon se një numër i madh komunash pësuan dëme të konsiderueshme në infrastrukturë publike, ekonomi familjare, bujqësi dhe biznese, duke dëshmuar nevojën për investime më të mëdha në masat parandaluese dhe mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve.

144. Raportet evidentojnë gjithashtu mungesën e kapaciteteve institucionale në nivel lokal. Edhe pse disa komuna kanë emëruar inspektorë ose zyrtarë për mjedis, me përjashtime, mungojnë inspektorë të specializuar për mbrojtjen e ujërave, monitorimin e ndotjes dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Numri i kufizuar i personelit profesional dhe mungesa e profileve teknike e vështirësojnë mbikëqyrjen efektive të ndotësve dhe zbatimin e masave mbrojtëse[48].

145. Sfidë e rëndësishme mbetet edhe menaxhimi i ndotjes nga burimet komunale dhe difuze. Shkarkimet e ujërave të zeza, deponitë e mbeturinave pranë rrjedhave ujore, përdorimi i plehrave kimike dhe sistemeve septike, si dhe presionet nga zhvillimi urban dhe aktivitetet ekonomike, vazhdojnë të ndikojnë negativisht në cilësinë e ujërave. Raporti i ARPL-së i identifikon këto si ndër presionet kryesore mbi trupat ujorë në Kosovë.

Analiza juridike

Garancitë kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e cilësisë së ujërave

146. Mbrojtja e cilësisë së ujërave nuk përbën vetëm një çështje të politikave publike ose të administrimit të resurseve natyrore, por një detyrim kushtetues dhe ligjor të shtetit për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Resurset ujore janë të lidhura drejtpërdrejt me mbrojtjen kushtetuese të së drejtës për jetë, të jetës private dhe familjare, pronës dhe shëndetit, si dhe me përgjegjësinë kushtetuese për mjedisin jetësor të përcaktuar në nenin 52 të Kushtetutës.

147. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e njeh në mënyrë të shprehur të drejtën për ujë si të drejtë të veçantë kushtetuese. Megjithatë, ajo garanton një sërë të drejtash dhe parimesh kushtetuese, interpretimi i të cilave imponon detyrimin e shtetit për të mbrojtur resurset ujore dhe për të siguruar cilësinë e tyre. Në këtë drejtim, neni 52 i Kushtetutës përcakton se natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi e secilit, ndërsa institucionet publike kanë obligim të garantojnë që secilit t'i

[47]Raporti Vjetor i AMMK-së për gjendjen e mjedisit për vitin 2024: https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20vjetor%20i%20gjendjes%20se%20mjedisit%202024%20al.pdf

[48] Po aty.

ofrohet mundësia për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor në të cilin jeton. Kjo dispozitë nuk krijon vetëm një përgjegjësi individuale, por edhe një detyrim të qartë për autoritetet publike që të ndërmarrin masa efektive për ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe të burimeve ujore.

148. Garancitë kushtetuese për mbrojtjen e ujërave duhet të interpretohen gjithashtu në dritën e nenit 53 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk përmban një dispozitë të veçantë për mbrojtjen e mjedisit ose të ujërave, Gjykata Evropiane ka zhvilluar ndër vite një praktikë të konsoliduar gjyqësore, sipas së cilës ndotja e mjedisit, degradimi i burimeve ujore dhe dështimi i autoriteteve për të parandaluar ose kontrolluar këto rreziqe mund të cenojnë të drejtat e garantuara nga Konventa, veçanërisht të drejtën për jetën, respektimin e jetës private dhe familjare, mbrojtjen e pronës, si dhe të drejtën për mjete juridike efektive. Kjo praktikë ka vendosur standarde të qarta mbi detyrimet pozitive të shtetit për të parandaluar dëmtimin e mjedisit, për të kontrolluar aktivitetet ndotëse, për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe për të garantuar mbrojtje efektive gjyqësore. Praktika konkrete e Gjykatës Evropiane do të trajtohet në mënyrë të veçantë në kapitullin vijues të këtij raporti.

149. Në nivel ligjor, mbrojtja e cilësisë së ujërave është ndërtuar mbi një kornizë të gjerë normative, e harmonizuar në masë të konsiderueshme me Acquis-in e Bashkimit Evropian në fushën e ujërave. Akti themelor është Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili i përcakton ujërat si pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë të Republikës së Kosovës, duke vendosur si objektiva kryesore mbrojtjen, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore. Ligji bazohet në parimet e menaxhimit të integruar sipas pellgjeve lumore, parandalimit të ndotjes, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe mbrojtjes së ekosistemeve ujore.

150. Korniza ligjore plotësohet edhe nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, si dhe nga një numër i konsiderueshëm aktesh nënligjore që rregullojnë monitorimin e cilësisë së ujërave, klasifikimin e trupave ujorë, mbrojtjen e ujit për konsum njerëzor, menaxhimin e rrezikut nga vërshimet, zonat mbrojtëse të burimeve ujore dhe procedurat për dhënien e lejeve ujore. Kjo kornizë juridike përcakton kompetencat e institucioneve përgjegjëse, mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes, si dhe detyrimet për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së ujërave.

151. Nga analiza e kësaj kornize normative rezulton se legjislacioni i Kosovës krijon një bazë të mjaftueshme juridike për mbrojtjen e cilësisë së ujërave. Megjithatë, realizimi efektiv i këtyre garancive kushtetuese dhe ligjore nuk varet vetëm nga ekzistenca e dispozitave ligjore, por nga zbatimi praktik i tyre nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, detyrimi i shtetit nuk kufizohet vetëm në miratimin e ligjeve, por përfshin edhe detyrimin për të organizuar një sistem funksional të menaxhimit të resurseve ujore, për të monitoruar vazhdimisht cilësinë e ujërave, për të parandaluar dhe sanksionuar ndotjen, për të mbrojtur burimet ujore, për të siguruar koordinim efektiv ndërinstitucional dhe për të ndërmarrë masa konkrete për eliminimin e rreziqeve që cenojnë shëndetin e popullatës dhe mjedisin.

152. Avokati i Popullit rikujton se gjendja dhe cilësia e ujërave paraqesin një faktor thelbësor

për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit. Mbrojtja e burimeve ujore, si element jetik për ekzistencën dhe mirëqenien e njerëzve, përbën një nga objektivat strategjike të politikave shtetërore në fushën e menaxhimit të ujërave.

153. Ligji për Ujërat e Kosovës i përcakton burimet ujore si pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë të Republikës së Kosovës, duke e bërë mbrojtjen e tyre nga ndotja, degradimi dhe tejshfrytëzimi një nga qëllimet themelore të këtij ligji (neni 2). Në këtë drejtim, institucionet përgjegjëse kanë detyrimin të ndërmarrin masa parandaluese dhe mbrojtëse për ruajtjen e cilësisë së ujërave, duke adresuar burimet kryesore të ndotjes, përfshirë ndotjet urbane nga ujërat e zeza dhe burime të tjera joindustriale, ndotjet industriale, si dhe ndotjet difuze, veçanërisht ato që rrjedhin nga aktivitetet bujqësore.

154. Prandaj, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, standardi kushtetues dhe ligjor që rregullon mbrojtjen e ujërave nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm për shkak të ekzistencës së një kuadri normativ. Përkundrazi, këto dispozita imponojnë një detyrim të vazhdueshëm për autoritetet publike që të ndërmarrin masa efektive, të koordinuara dhe të bazuara në evidencë për mbrojtjen e cilësisë së ujërave, parandalimin e degradimit të tyre dhe garantimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të njeriut që varen drejtpërdrejt nga gjendja e resurseve ujore. Pikërisht në dritën e këtyre detyrimeve kushtetuese dhe ligjore duhet të vlerësohen edhe mangësitë dhe sfidat e evidentneuara në këtë raport lidhur me monitorimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave në Republikën e Kosovës.

155. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2025 e vlerëson se Kosova mbetet në fazë të hershme të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, ndërsa gjatë periudhës raportuese ka shënuar vetëm progres të kufizuar. Për sa i përket ujërave, raporti thekson se mbrojtja e mjedisit, përfshirë edhe burimet ujore, vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme institucionale dhe në zbatimin e legjislacionit. Edhe pse Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka ndërmarrë disa hapa për forcimin e kapaciteteve administrative, ristrukturimi i saj ende nuk është përfunduar, duke ndikuar në zbatimin efektiv të politikave mjedisore.

156. Për sa i përket cilësisë së ujërave, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2025 nuk paraqet të dhëna të detajuara për gjendjen e lumenjve apo parametrat e ndotjes, por vlerëson se Kosova duhet të përshpejtojë zbatimin e Acquis-it të BE-së në sektorin e mjedisit dhe të forcojë menaxhimin e burimeve natyrore. Komisioni Evropian rekomandon që gjatë periudhës së ardhshme të ndërmerren masa konkrete, përfshirë: sigurimin e mbrojtjes efektive të zonave të mbrojtura dhe parandalimin e ndotjes së tyre; ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave; si dhe zbatimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike dhe harmonizimin me sistemin e BE-së për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin (MRVA). Këto masa synojnë përmirësimin e përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit dhe, rrjedhimisht, edhe të cilësisë së ujërave në Kosovë[49].

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ujërave

[49]Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2025: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/127563ea-4c03-44a4-b56c-2d569afd86a5_en?filename=kosovo-report-2025.pdf

157. Avokati i Popullit, duke u mbështetur në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), vëren se GjEDNj-ja ka zhvilluar një praktikë gjyqësore të konsoliduar lidhur me mbrojtjen e mjedisit, përfshirë mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe ndikimin në gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut. Në vijim, Avokati i Popullit paraqet disa nga rastet më relevante, të cilat kanë rëndësi për vlerësimin e detyrimeve pozitive të shtetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me theks të veçantë në cilësinë e ujërave dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

158. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, autoritetet publike janë të detyruara të ndërmarrin masa konkrete për të siguruar që të drejtat e njeriut të mos preken seriozisht nga faktorë të dëmshëm mjedisorë.

159. Në rastin *López Ostra kundër Spanjës, 1994*, GjEDNj-ja shqyrtoi ndikimin e kundërmimit, zhurmës dhe tymrave ndotës të shkaktuar nga një impiant për trajtimin e mbeturinave, i cili ndodhej vetëm disa metra larg banesës së ankueses. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), duke vlerësuar se shteti nuk kishte arritur të vendoste një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit ekonomik të qytetit për funksionimin e impiantit dhe të së drejtës së ankueses për gëzimin efektiv të banesës dhe respektimin e jetës së saj private dhe familjare. Në këtë kontekst, ky rast vendosi një standard të rëndësishëm, sipas të cilit dëmtimi serioz i mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe në gëzimin e banesës së tyre në atë mënyrë që të cenojë jetën private dhe familjare, edhe pa rrezikuar seriozisht shëndetin e tyre.

160. Në rastin *Hudorovič dhe të tjerët kundër Sllovenisë, 2020*, GjEDNj-ja shqyrtoi pretendimet se autoritetet nuk u kishin siguruar ankuesve qasje të mjaftueshme në ujë të pijshëm të sigurt dhe shërbime sanitare. Gjykata sqaroi se qasja në ujë të pijshëm nuk përbën, si e tillë, një të drejtë autonome sipas nenit 8 të KEDNj-së. Megjithatë, mungesa e vazhdueshme dhe afatgjate e ujit të sigurt mund të ndikojë në shëndetin dhe dinjitetin njerëzor dhe, në rrethana të caktuara, të aktivizojë detyrimet pozitive të shtetit. Në rastin konkret, Gjykata vlerësoi se autoritetet kishin ndërmarrë masa të arsyeshme për t'u siguruar ankuesve qasje në ujë, duke marrë parasysh edhe pozitën e tyre të cenueshme, dhe se shteti nuk kishte detyrim të mbulonte tërësisht sigurimin e ujit të rrjedhshëm në çdo banesë. Për rrjedhojë, GjEDNj-ja konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

161. Në rastin *Dubetska dhe të tjerët kundër Ukrainës, 2011*, GjEDNj-ja shqyrtoi ndikimin e ndotjes së shkaktuar nga një minierë shtetërore e qymyrit dhe një fabrikë për përpunimin e qymyrit në jetën e banorëve përreth, përfshirë ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe vështirësitë e vazhdueshme për qasje në ujë të pijshëm të sigurt. Matjet kishin treguar se uji i puseve nuk i përmbushte standardet e sigurisë, me tejkalime të konsiderueshme të nitrateve, hekurit dhe manganit. Gjykata vlerësoi se, edhe kur nuk mund të provohet në mënyrë të matshme dëmi konkret shëndetësor, jetesa në një zonë ku ndotja tejkalon dukshëm standardet e sigurisë i ekspozon banorët ndaj një rreziku të shtuar për shëndetin; ndërsa në rastin konkret ndotja e ujit dhe vështirësitë për sigurimin e ujit të pakontaminuar kishin ndikuar edhe në cilësinë e jetës së ankuesve. Përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit, GjEDNj-ja theksoi se autoritetet duhet të ndërmarrin masa efektive dhe në kohë për të kontrolluar rreziqet mjedisore, duke zgjedhur, sipas rrethanave, ndërmjet zvogëlimit të ndotjes dhe zhvendosjes së personave të prekur në një

zonë më të sigurt. Ndonëse autoritetet kishin ndërmarrë disa masa dhe deri në vitin 2009 kishin ndërtuar një ujësjellës të centralizuar, Gjykata konstatoi se për më shumë se dymbëdhjetë vjet nuk kishin siguruar një zgjidhje efektive për situatën e ankuesve. Për rrjedhojë, GjEDNj-ja konstatoi se shteti nuk kishte vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të komunitetit dhe të drejtave të ankuesve dhe gjeti shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

Detyrimet e shtetit në dritën e parimeve për mbrojtjen e ujërave

162. Mbrojtja e resurseve ujore nuk kufizohet vetëm në ndalimin e ndotjes ose në administrimin teknik të ujërave, por përbën një detyrim të vazhdueshëm të autoriteteve publike për të siguruar ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme. Ky detyrim buron nga parimet e së drejtës ndërkombëtare, standardet evropiane dhe legjislacioni vendor, të cilat kërkojnë që shteti të ndërmarrë masa parandaluese, mbrojtëse dhe korrigjuese për të garantuar cilësinë dhe disponueshmërinë e burimeve ujore për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

163. Në nivel ndërkombëtar, mbrojtja e ujërave mbështetet në një sërë parimesh themelore të së drejtës mjedisore, të cilat janë bërë pjesë e standardeve të pranuara ndërkombëtarisht. Ndër to, rëndësi të veçantë kanë parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, parimi i parandalimit, parimi i kujdesit (precautionary principle), parimi "ndotësi paguan", parimi i menaxhimit të integruar të resurseve ujore sipas pellgjeve lumore, si dhe parimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Këto parime kërkojnë që autoritetet publike të mos kufizohen në reagimin ndaj pasojave të ndotjes, por të veprojnë në mënyrë proaktive për ta parandaluar atë, duke identifikuar rreziqet në kohë dhe duke ndërmarrë masa efektive për eliminimin ose minimizimin e tyre.

164. Në të njëjtën linjë, Acquis-i i Bashkimit Evropian, veçanërisht Direktiva Kornizë për Ujërat (2000/60/EC), e vendos menaxhimin sipas pellgjeve lumore si parimin themelor të administrimit të ujërave dhe synon arritjen e gjendjes së mirë ekologjike dhe kimike të të gjitha trupave ujorë. Ky standard nuk kufizohet në monitorimin e cilësisë së ujit, por kërkon planifikim afatgjatë, koordinim ndërinstitucional, monitorim të vazhdueshëm, identifikimin e presioneve dhe burimeve të ndotjes, si dhe zbatimin e masave konkrete për përmirësimin e gjendjes së ujërave.

165. Edhe legjislacioni i Republikës së Kosovës është ndërtuar mbi këto parime. Ligji për Ujërat e Kosovës e përcakton mbrojtjen e resurseve ujore si një nga objektivat themelore të menaxhimit të ujërave dhe vendos detyrimin për ruajtjen e cilësisë së tyre, përdorimin racional, parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore. Njëkohësisht, ligji kërkon që menaxhimi i ujërave të bazohet në planifikim sipas pellgjeve lumore, monitorim sistematik, kontroll të shkarkimeve ndotëse, mbrojtje të burimeve ujore dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

166. Nga këto parime rezulton se autoritetet publike kanë detyrime pozitive që shkojnë përtej nxjerrjes së legjislacionit. Ato obligohen të krijojnë mekanizma efektivë për monitorimin e cilësisë së ujërave, të sigurojnë funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe inspektimit, të identifikojnë dhe eliminojnë burimet e ndotjes, të ndërmarrin masa për trajtimin e ujërave të ndotura, të mbrojnë zonat ujëmbledhëse dhe burimet e ujit të pijshëm, si dhe të garantojnë koordinim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Po aq i rëndësishme është edhe sigurimi i transparencës, qasjes në informata dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse që kanë ndikim mbi resurset ujore.

167. Në këtë kontekst, detyrimet e shtetit nuk konsiderohen të përmbushura vetëm përmes ekzistencës së një kuadri ligjor ose strategjik. Standardet ndërkombëtare dhe vendore kërkojnë që autoritetet të demonstrojnë rezultate konkrete në mbrojtjen e cilësisë së ujërave, në parandalimin e degradimit të tyre dhe në rikthimin e trupave ujorë në gjendje të mirë ekologjike kur ata janë dëmtuar. Mosveprimi, vonesat në zbatimin e legjislacionit, mungesa e monitorimit efektiv, koordinimi i pamjaftueshëm institucional ose dështimi për të parandaluar ndotjen janë në mospërputhje me këto standarde dhe cenojnë efektivitetin e mbrojtjes së resurseve ujore.

Fuqizimi institucional për zbatimin efektiv të legjislacionit për ujërat

168. Ekzistenca e një kuadri të avancuar kushtetues dhe ligjor nuk garanton, në vetvete, mbrojtjen efektive të resurseve ujore. Efektiviteti i këtij kuadri varet nga funksionimi i institucioneve përgjegjëse, disponueshmëria e kapaciteteve profesionale, teknike dhe financiare, si dhe nga ekzistenca e procedurave të qarta që mundësojnë zbatimin praktik të detyrimeve ligjore. Për këtë arsye, fuqizimi institucional, përfshirë edhe atë të pushtetit lokal, përbën një nga parakushtet themelore për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.

169. Standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor u imponojnë shteteve jo vetëm detyrimin për të nxjerrë legjislacion, por edhe për të krijuar institucione funksionale, të pajisura me burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike për zbatimin e tij. Kjo nënkupton organizimin e një sistemi efektiv të monitorimit të cilësisë së ujërave, inspektimit, mbikëqyrjes, planifikimit sipas pellgjeve lumore, koordinimit ndërinstitucional dhe reagimit të shpejtë ndaj rasteve të ndotjes ose degradimit të resurseve ujore.

170. Struktura institucionale përgjegjëse për menaxhimin e resurseve ujore përfshin institucionet qendrore, autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e pellgjeve lumore, institucionet monitoruese, organet inspektuese, si dhe komunat, të cilave legjislacioni u ngarkon kompetenca të rëndësishme në mbrojtjen e ujërave, administrimin e ujërave atmosferike, mirëmbajtjen e infrastrukturës ujore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore në nivel lokal. Megjithatë, funksionimi i këtij sistemi vazhdon të përballet me sfida në aspektin e koordinimit ndërinstitucional, kapaciteteve administrative dhe zbatimit efektiv të legjislacionit.

171. Në këtë drejtim, Ligji për Ujërat e Kosovës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacioni tjetër sektorial u kanë besuar institucioneve përgjegjëse kompetenca të gjera për planifikimin, monitorimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e resurseve ujore, ushtrimi efektiv i të cilave kërkon procedura të standardizuara, koordinim të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe kapacitete të mjaftueshme profesionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

172. Nga analiza e informatave të siguruara gjatë hetimit ex officio, rezulton se një nga sfidat kryesore në sektorin e ujërave vazhdon të jetë mungesa e kapaciteteve institucionale. Vetë institucionet përgjegjëse kanë evidentuar mungesë të personelit profesional, nevojë për pajisje laboratorike bashkëkohore, zgjerim të rrjeteve monitoruese dhe ngritje të vazhdueshme profesionale të stafit. IHMK-ja ka bërë të ditur se prej shumë vitesh përballet me mungesë të stafit, se laboratorët kanë nevojë për pajisje të reja për shkak të amortizimit të pajisjeve ekzistuese, ndërsa rrjeti për monitorimin e ujërave nëntokësore mbetet ende i pamjaftueshëm në disa pellgje lumore. Gjithashtu është evidentuar nevoja

për shtimin e stacioneve monitoruese dhe për zhvillimin sistematik të monitorimit biologjik të ujërave, në përputhje me kërkesat e Direktivës Kornizë për Ujërat.

173. Mangësitë janë veçanërisht të theksuara në nivelin lokal. Sipas informatave të ofruara nga ARPL-ja më 30 korrik 2026, në shumicën e komunave mungojnë zyrtarët mjedisorë dhe inspektorët mjedisorë, ndërsa shumica e komunave nuk kanë hartuar plane lokale për mbrojtjen e mjedisit dhe, pavarësisht rekomandimeve të MMPHI-së dhe ARPL-së për planifikimin dhe plotësimin e këtyre pozitave, komunat nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme. Po ashtu, ARPL-ja ka evidentuar mungesën e kapaciteteve profesionale dhe të burimeve njerëzore në komuna, si dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm të tyre me nivelin qendror në çështjet që lidhen me mjedisin dhe ujërat. Avokati i Popullit konsideron se këto mangësi nuk paraqesin vetëm çështje të organizimit të brendshëm komunal, por ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e autoriteteve lokale për të parandaluar, identifikuar dhe trajtuar shkeljet që cenojnë resurset ujore.

174. Në mënyrë të ngjashme, dokumentet strategjike të institucioneve përgjegjëse kanë identifikuar se menaxhimi i resurseve ujore në Kosovë vazhdon të karakterizohet nga kompetenca të shpërndara ndërmjet institucioneve të ndryshme, koordinim jo gjithmonë efektiv dhe shkallë e ulët e zbatimit të objektivave strategjike. Këto mangësi ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e institucioneve qendrore dhe lokale për të parandaluar ndotjen, për të monitoruar gjendjen e ujërave, për të zbatuar kontrolle efektive dhe për të reaguar në kohë ndaj problemeve të evidentuara.

175. Të dhënat e ARPL-së evidentojnë gjithashtu nevojën për fuqizimin e koordinimit horizontal ndërmjet institucioneve qendrore. Në veçanti, ARPL-ja ka ngritur nevojën për rregullimin më të qartë të bashkëpunimit ndërmjet MMPH-së dhe MBPZhR-së në çështjet që lidhen me shfrytëzimin e ujërave për ujitjen e tokave bujqësore, duke raportuar raste të shfrytëzimit të ujit pa pajisje me lejen përkatëse nga MMPH-ja. Duke qenë se MBPZhR-ja, përmes politikave të ujitjes dhe menaxhimit të tokës bujqësore, ushtron veprimtari që ndikojnë drejtpërdrejt në resurset ujore, ndërsa administrimi i lejeve ujore dhe mbrojtja e këtyre resurseve bien në përgjegjësinë e strukturave të MMPH-së dhe ARPL-së, kjo gjendje evidenton ndërvarësinë e këtyre kompetencave dhe nevojën për bashkëpunim. Për këtë arsye, mungesa e mekanizmave të qartë të koordinimit mund të krijojë boshllëqe në kontrollin e shfrytëzimit të ujërave dhe në zbatimin e regjimit të lejeve ujore.

176. Nevoja për fuqizim institucional lidhet gjithashtu me aftësinë e institucioneve për t'i zbatuar dokumentet strategjike dhe planet e miratuara. ARPL-ja ka njoftuar se ende nuk është realizuar një vlerësim i zbatimit të Rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027, ndonëse janë ndërmarrë veprime të ndryshme dhe disa prej tyre janë në proces. Në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura është raportuar për ndërtimin dhe funksionalizimin e impianteve, si dhe për impiante të tjera në proces, ndërsa është theksuar nevoja për trajtimin e ujërave të ndotura në vendbanimet me mbi 2 mijë banorë dhe përgjegjësia e komunave për planifikimin e nevojave përkatëse. Kjo tregon se, krahas miratimit të dokumenteve strategjike, është i nevojshëm monitorimi periodik dhe i matshëm i zbatimit të tyre, në mënyrë që të identifikohen progresi, vonesat dhe përgjegjësitë institucionale.

177. Në këtë drejtim, fuqizimi institucional duhet të shoqërohet edhe me fuqizimin procedural. Duhet të ekzistojnë mekanizma funksionalë për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve, koordinimin ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, monitorimin e

zbatimit të dokumenteve strategjike, kontrollin e respektimit të lejeve ujore dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësive në rastet kur kompetencat e institucioneve të ndryshme ndërthuren. Në të njëjtën kohë, komunat duhet të sigurojnë që planifikimi urban dhe zhvillimor të harmonizohet me dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit qendror dhe me kërkesat për mbrojtjen e resurseve ujore.

178. Avokati i Popullit vlerëson se të dhënat e mbledhura gjatë hetimit dëshmojnë se sfida në sektorin e ujërave nuk qëndron vetëm në përmbajtjen e kuadrit ligjor, por në kapacitetin real të institucioneve për ta zbatuar atë. Mungesa e personelit profesional dhe inspektues, kapacitetet e kufizuara në nivel komunal, mungesa e planeve lokale për mbrojtjen e mjedisit, koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve dhe mungesa e vlerësimit sistematik të zbatimit të dokumenteve strategjike krijojnë një hendek ndërmjet detyrimeve të përcaktuara me ligj dhe realizimit të tyre në praktikë.

179. Për rrjedhojë, sipas Avokatit të Popullit, është e domosdoshme që autoritetet kompetente të ndërmarrin masa të koordinuara për plotësimin e kapaciteteve profesionale dhe inspektuese në nivel qendror dhe lokal; plotësimin e pozitave të zyrtarëve dhe inspektorëve përgjegjës për mjedisin dhe ujërat në komuna; hartimin dhe zbatimin e planeve lokale për mbrojtjen e mjedisit; modernizimin e laboratorëve dhe zgjerimin e rrjeteve monitoruese; fuqizimin e monitorimit biologjik; si dhe krijimin e mekanizmave të qartë të bashkëpunimit ndërmjet MMPH-së, ARPL-së, MBPZhR-së dhe komunave. Në të njëjtën kohë, zbatimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra dhe dokumenteve të tjera strategjike duhet t'i nënshtrohet vlerësimit periodik, përmes treguesve të matshëm dhe përcaktimit të qartë të përgjegjësisë institucionale.

180. Avokati i Popullit konsideron se fuqizimi institucional në fushën e ujërave duhet të trajtohet si proces i vazhdueshëm dhe si pjesë e detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e mjedisit dhe të të drejtave të njeriut. Vetëm institucione qendrore dhe lokale me kapacitete të mjaftueshme, përgjegjësi të qarta, mekanizma funksionalë mbikëqyrës dhe koordinim efektiv mund të sigurojnë që legjislacioni dhe dokumentet strategjike të mos mbeten vetëm në nivel normativ, por të përkthehen në rezultate konkrete dhe të matshme për mbrojtjen, cilësinë, sigurinë dhe disponueshmërinë e resurseve ujore.

Urgjenca e ndërmarrjes së masave prioritare

181. Nga analiza e gjendjes së resurseve ujore në Republikën e Kosovës, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e problemeve të evidentuara nuk janë të reja, por janë raportuar ndër vite nga institucionet publike, organizatat ndërkombëtare, Avokati i Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile. Pavarësisht ekzistencës së legjislacionit, strategjive dhe dokumenteve planifikuese, zbatimi i masave ka avancuar me ritëm të pamjaftueshëm, ndërsa një numër i konsiderueshëm i problemeve vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit vlerëson se nuk ekziston më nevoja për analiza shtesë mbi ekzistencën e problemeve, por për veprime konkrete dhe të koordinuara nga autoritetet përgjegjëse.

182. Mbrojtja e resurseve ujore nuk mund të shtyhet për periudha të gjata kohore, dhe kërkon ndërmarrjen e veprimeve urgjente, pasi degradimi i tyre është në shumë raste proces progresiv dhe, në raste të caktuara, edhe i pariparueshëm. Çdo vonesë në zbatimin e masave rrit shkallën e ndotjes, përkeqëson gjendjen ekologjike të lumenjve dhe liqeneve, rrit kostot ekonomike të rehabilitimit dhe ndikon drejtpërdrejt në shëndetin publik, biodiversitetin, furnizimin me ujë të pijshëm dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Për

këtë arsye, detyrimet ligjore të institucioneve duhet të zbatohen brenda afateve të arsyeshme dhe me nivel të lartë të përgjegjësisë institucionale.

183. Vonesat në ndërmarrjen e veprimeve kanë pasoja që shtrihen përtej aspektit mjedisor. Mosndërtimi në kohë i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, mungesa e rehabilitimit të lumenjve të degraduar, monitorimi i pamjaftueshëm i cilësisë së ujërave, mungesa e mbrojtjes efektive të burimeve të ujit të pijshëm, vonesat në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të rrezikut nga vërshimet, si dhe mosfuqizimi i institucioneve përgjegjëse ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin efektiv të të drejtave të njeriut, veçanërisht të së drejtës për shëndet, mjedis të shëndetshëm dhe qasje në ujë të sigurt.

184. Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, autoritetet publike duhet të udhëhiqen nga një qasje e bazuar në prioritete, duke orientuar burimet njerëzore, financiare dhe administrative drejt çështjeve që paraqesin rrezikun më të madh për shëndetin e popullatës dhe mjedisin. Në këtë kuadër, prioritet absolut duhet t'u jepet masave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, siç janë mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm, përmirësimi i monitorimit të cilësisë së ujërave, zgjerimi i trajtimit të ujërave të ndotura, parandalimi i shkarkimeve të pakontrolluara, rehabilitimi i lumenjve më të degraduar dhe forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe inspektimit.

185. Po aq prioritare mbetet edhe ndërmarrja e masave për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet, duke përfunduar dokumentet planifikuese, duke zbatuar masat parandaluese dhe duke fuqizuar sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm. Ndryshimet klimatike, urbanizimi i pakontrolluar dhe degradimi i shtretërve të lumenjve e kanë rritur ndjeshëm ekspozimin e popullatës ndaj përmbytjeve. Prandaj çdo vonesë në këtë drejtim rrit rrezikun për jetën, pronën dhe infrastrukturën publike.

186. Në mënyrë të njëjtë, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative duhet të trajtohen si masa prioritare horizontale, pasi realizimi efektiv i të gjitha objektivave të tjera varet nga funksionimi i institucioneve përgjegjëse. Përvoja e deritanishme tregon se shumë nga mangësitë e evidentuara nuk burojnë nga mungesa e bazës ligjore, por nga vonesat në zbatimin e saj, mungesa e koordinimit institucional dhe kapacitetet e pamjaftueshme për monitorim, mbikëqyrje dhe zbatim.

187. Avokati i Popullit vlerëson se institucionet përgjegjëse duhet të trajtojnë çështjet e evidentuara në këtë raport si prioritete të politikave publike dhe, pa vonesa të mëtejshme, të ndërmarrin masa konkrete, të koordinuara dhe të matshme. Vetëm përmes një qasjeje të tillë mund të parandalohet përkeqësimi i mëtejshëm i gjendjes së ujërave, të zvogëlohen kostot e rehabilitimit në të ardhmen dhe të sigurohet mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut, në përputhje me detyrimet kushtetuese, ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

188. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, në analizën e legjislacionit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konstaton si vijon:

189. Avokati i Popullit konstaton se gjendja e resurseve ujore në Republikën e Kosovës vazhdon të karakterizohet nga sfida të konsiderueshme në aspektin e mbrojtjes, menaxhimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm. Ndotja e ujërave, degradimi i shtretërve të lumenjve, mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura, ndërhyrjet e pakontrolluara në

ekosistemet ujore dhe dobësitë në zbatimin e legjislacionit kanë ndikuar në cenimin e cilësisë së ujërave dhe të së drejtës së qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Këto shqetësime Avokati i Popullit i ka evidentuar vazhdimisht edhe në raportet e mëparshme me rekomandime dhe në raportet vjetore të adresuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

190. Avokati i Popullit konstaton se zhvillimi i projekteve hidroenergjetike dhe eksploatimi i pakontrolluar i inerteve nga lumenjtë kanë shkaktuar pasoja të konsiderueshme në ekosistemet ujore. Gjetjet e paraqitura në këtë raport tregojnë se në një numër rastesh këto aktivitete janë shoqëruar me mangësi në respektimin e procedurave ligjore, standardeve mjedisore dhe parimeve të transparencës e pjesëmarrjes së publikut, ndërsa eksploatimi i pakontrolluar i inerteve ka dëmtuar morfologjinë e lumenjve, ka rritur rrezikun nga përmbytjet dhe ka shkaktuar degradim afatgjatë të shtretërve lumorë, për sanimin e të cilit nuk janë ndërmarrë masa efektive dhe të mjaftueshme nga autoritetet kompetente.

191. Avokati i Popullit vlerëson se rreziku nga përmbytjet vazhdon të paraqesë një sfidë të rëndësishme për mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit. Ky rrezik ndërlidhet jo vetëm me faktorët natyrorë dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike, por edhe me degradimin e shtretërve të lumenjve, urbanizimin e pakontrolluar dhe mangësitë në infrastrukturën për mbrojtje nga përmbytjet. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh faktin se Plani për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet është përfunduar, efektiviteti i këtij dokumenti do të varet nga zbatimi i tij praktik, sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe institucionale, koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, si dhe integrimi i masave për mbrojtje nga përmbytjet në planifikimin hapësinor dhe urban të komunave.

192. Avokati i Popullit konstaton se Republika e Kosovës ka arritur nivel të lartë të furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm përmes sistemeve publike të ujësjellësit, duke shënuar progres në realizimin e së drejtës për qasje në ujë të sigurt. Megjithatë, sigurimi i kësaj të drejte nuk mund të konsiderohet i përmbushur plotësisht përderisa një pjesë e popullsisë vazhdon të mos ketë qasje të barabartë në ujë të sigurt dhe në shërbime adekuate të sanitacionit. Po ashtu, sistemet lokale të furnizimit me ujë që nuk administrohen nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit vazhdojnë të paraqesin një nga segmentet më problematike të furnizimit me ujë të pijshëm. Mungesa e mbikëqyrjes së rregullt institucionale, monitorimit sistematik të cilësisë së ujit dhe zbatimit të masave mbrojtëse për burimet ujore rrit rrezikun për shëndetin publik, veçanërisht në zonat rurale. Përmbushja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm kërkon masa të mëtejshme ligjore, institucionale dhe financiare për garantimin e qasjes universale dhe të barabartë në këto shërbime.

193. Avokati i Popullit konstaton se kapacitetet institucionale për menaxhimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e ujërave mbeten të pamjaftueshme. Mungesa e numrit të nevojshëm të profesionistëve, pajisjeve moderne monitoruese dhe laboratorike, si dhe mungesa e inspektorëve të ujërave në nivel qendror dhe komunal kufizojnë ndjeshëm zbatimin efektiv të legjislacionit dhe ushtrimin e përgjegjësive ligjore nga autoritetet kompetente. Në veçanti, mungesa e kapaciteteve inspektuese në komuna dobëson mbikëqyrjen e aktiviteteve që ndikojnë në resurset ujore dhe pengon reagimin efektiv ndaj ndotjes dhe shkeljeve mjedisore.

194. Avokati i Popullit konstaton se monitorimet dhe analizat e institucioneve kompetente dëshmojnë se një numër lumenjsh kryesorë vazhdojnë të karakterizohen nga tejkalime të parametrave fiziko-kimikë mbi standardet e lejuara, kryesisht si rezultat i shkarkimit të ujërave të patrajtuara, aktiviteteve industriale, bujqësisë intensive dhe hedhjes së mbeturinave në lumenj. Gjithashtu, rastet e përsëritura të tejkalimit të vlerave të manganit në ujin e pijshëm në zona të caktuara tregojnë nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe ndërmarrje të masave parandaluese për garantimin e cilësisë së ujit për konsum njerëzor.

195. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet publike nuk kanë siguruar gjithmonë transparencë të plotë, informim të mjaftueshëm dhe pjesëmarrje efektive të publikut në proceset vendimmarrëse që lidhen me shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore. Kjo bie ndesh me parimet e qeverisjes së mirë, të së drejtës për informim dhe pjesëmarrjes publike në çështjet mjedisore, të garantuara nga standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor.

196. Avokati i Popullit konsideron se, megjithëse kuadri ligjor dhe strategjik në fushën e ujërave është zhvilluar dhe është përafruar me Acquis-in e Bashkimit Evropian, sfida themelore vazhdon të mbetet zbatimi i tij efektiv në praktikë, për shkak të mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme institucionale, koordinimit ndërinstitucional, mbikëqyrjes efektive dhe monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së resurseve ujore. Për këtë arsye, përveç avancimit të mëtejshëm të kuadrit normativ, është i domosdoshëm forcimi i mekanizmave institucionalë dhe sigurimi i zbatimit efektiv të detyrimeve ligjore në të gjitha nivelet e qeverisjes.

197. Avokati i Popullit konstaton se komunat, pavarësisht kompetencave dhe përgjegjësive të rëndësishme që ushtrojnë në mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave atmosferike, planifikimin hapësinor dhe trajtimin e ujërave të ndotura, nuk kanë në mënyrë të njëtrajtshme kapacitete institucionale të nevojshme për ushtrimin efektiv të këtyre përgjegjësive. Avokati i Popullit konsideron se këto rrethana krijojnë hendek ndërmjet kompetencave që ligji u ngarkon komunave dhe aftësisë së tyre reale për t'i ushtruar ato, duke ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e mbrojtjes së resurseve ujore dhe në parandalimin e dëmeve mjedisore.

198. Avokati i Popullit konstaton se menaxhimi efektiv i resurseve ujore kërkon jo vetëm kapacitete të mjaftueshme brenda secilit institucion, por edhe mekanizma të qartë dhe funksionalë të koordinimit ndërinstitucional. Avokati i Popullit vlerëson se ndërthurja e kompetencave ndërmjet institucioneve, pa procedura të qarta koordinimi, shkëmbimi të informatave dhe mbikëqyrjeje, mund të krijojë boshllëqe në zbatimin e legjislacionit dhe të dobësojë kontrollin efektiv mbi shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore.

Andaj, Avokati i Popullit, bazuar në nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore"*, dhe në pajtim me nenin 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i

REKOMANDON

Qeverisë së Republikës së Kosovës:

1. *Të sigurojë vlerësimin periodik të zbatimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra, duke përcaktuar për secilën masë institucionin përgjegjës, afatin, buxhetin dhe treguesit e matshëm të realizimit, si dhe të publikojë rezultatet e vlerësimit.*
2. *Të krijojë mekanizëm të formalizuar të koordinimit ndërinstitucional për menaxhimin e resurseve ujore, në veçanti ndërmjet MMPHI-së, MBPZhR-së, dhe komunave, duke përcaktuar procedurat për shkëmbimin e informatave, kontrollin e shfrytëzimit të ujit dhe respektimin e regjimit të lejeve ujore.*
3. *Të sigurojë burimet e nevojshme buxhetore dhe njerëzore për fuqizimin e institucioneve përgjegjëse për ujërat, me prioritet plotësimin e pozitave profesionale dhe inspektuese, modernizimin e laboratorëve dhe zgjerimin e monitorimit të ujërave nëntokësore dhe biologjik.*
4. *Të sigurojë mbështetjen institucionale dhe financiare të nevojshme për nivelin lokal për rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.*

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

1. *Të ndërmarrë masat e nevojshme për hartimin dhe zbatimin e një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit të resurseve ujore, i cili garanton ruajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre, duke respektuar standardet ligjore dhe mjedisore.*
2. *Të përafrojë më tej legjislacionin vendor me standardet ndërkombëtare, përkatësisht transpozimin edhe më tej të legjislacionit të BE-së nga fusha e ujërave dhe mjedisit në legjislacionin vendor.*
3. *Të fuqizojë Departamentin për Inspektimin e Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave, duke siguruar numër të mjaftueshëm të inspektorëve mjedisorë dhe të ujërave në nivel vendi, t'ua sigurojë kushtet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin efektiv të inspektimeve në terren, si dhe program të rregullt të trajnimeve profesionale dhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të stafit inspektues.*
4. *Të rishikojë respektimin e kushteve të lejeve ujore dhe mjedisore të hidrocentraleve ekzistuese dhe të rishikojë kushtet dhe lejet e dhëna për hidrocentrale, duke siguruar që çdo projekt të zhvillohet në përputhje me ligjin, me transparencë, me vlerësim të plotë të ndikimit mjedisor dhe me pjesëmarrjen e publikut.*
5. *Në kuadër të kompetencave të saj, të ndërmarrë masa për fuqizimin e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës me staf të nevojshëm, kushte të punës dhe me pajisje të avancuara teknike dhe teknologjike, në mënyrë që të realizojnë monitorim të plotë, të rregullt të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe ta avancojë ueb-faqen zyrtare për nevoja më të qasshme të informimit.*
6. *Nëpërmjet ARPL-së dhe në koordinim me komunat, sipas kompetencave përkatëse, të sigurojë identifikimin, prioritizimin dhe rehabilitimin e segmenteve të degraduara të lumenjve nga eksploatimi i inerteve, duke identifikuar dhe prioritizuar zonat më të dëmtuara, si dhe të zbatojë masa të rregullta për pastrimin, mirëmbajtjen dhe rregullimin e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve, me prioritet segmentet e prekura nga degradimi,*

grumbullimi i mbeturinave dhe pengesat që cenojnë rrjedhën e ujit ose rrisin rrezikun nga vërshimet.

7. *Të krijojë mekanizëm të rregullt për verifikimin e zbatimit të vendimeve për zonat e mbrojtura sanitare, përfshirë kontrollin në terren dhe raportimin vjetor për nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse.*
8. *Të ndërmarrë masa efektive në koordinim me institucionet lokale për pastrimin dhe mbrojtjen e lumenjve nga ndotja, duke përfshirë: investimet në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, kontrollimin dhe sanksionimin/ndalimin e shkarkimeve industriale në lumenj, ndalimin e hedhjes së mbeturinave në lumenj, kontrollimin e ndotjes difuzive nga plehërimi i tokave bujqësore etj.*
9. *Të ndërmarrë masat për ndërprerjen e çdo forme të eksploatimit të pakontrolluar të rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve dhe të hartohen plane të qarta për rehabilitimin dhe rivitalizimin e zonave të degraduara.*
10. *Të krijojë një mekanizëm të formalizuar dhe të përhershëm të bashkëpunimit dhe koordinimit me komunat për çështjet e mjedisit dhe ujërave, përmes të cilit të përcaktohen përgjegjësitë përkatëse, afatet për realizimin e veprimeve, mënyra e raportimit dhe monitorimit të zbatimit. Në kuadër të këtij mekanizmi, MMPHI-ja, në bashkëpunim me ARPL-në, të kërkojë nga komunat përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fushën e mjedisit dhe ujërave, të ofrojë udhëzime dhe mbështetje profesionale për zbatimin e tyre dhe të monitorojë në mënyrë periodike progresin e arritur.*

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal:

1. *Duke pasur parasysh përgjegjësitë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të përcaktuara me nenin 16, paragrafin 1, të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, veçanërisht përgjegjësitë për mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve komunale, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve ligjore për komunat, si dhe monitorimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave të tyre, në bashkërendim me ministritë përkatëse, Avokati i Popullit i rekomandon MAPL-së që, në kuadër të mandatit dhe kompetencave të saj, të hartojë dhe të nxjerrë një Qarkore nëpërmjet së cilës, në mes tjerash do të kërkonte nga komunat zbatimin e rekomandimeve në vijim dhe njëkohësisht në kuadër të përgjegjësive të saj institucionale, të ofrojë mbështetjen, udhëzimet e nevojshme, si dhe të monitorojë zbatimin e këtyre rekomandimeve:*
   a) *Të hartojnë dhe zbatojnë planet lokale për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë masa të veçanta për mbrojtjen e lumenjve, menaxhimin e ujërave atmosferike, ndotjen nga ujërat e zeza dhe parandalimin e vërshimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike kombëtare, duke i integruar ato në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin lokal.*
   b) *Të sigurojnë që secila komunë të ketë zyrtar përgjegjës për mjedis dhe ujëra dhe inspektor të mjaftueshëm përkatës me kapacitet inspektues funksional (profesionale dhe teknike) për çështjet mjedisore dhe ujore, për të monitoruar, parandaluar dhe sanksionuar shkeljet që lidhen me ndotjen dhe eksploatimin e pakontrolluar të burimeve ujore.*

c) *Të ndërmarrin masa konkrete për pastrimin e lumenjve dhe ujërave dhe për parandalimin dhe kontrollin e hedhjes së mbeturinave dhe ujërave të ndotura në lumenj dhe burime ujore.*

d) *Të përgatisin vlerësime të fizibilitetit dhe plane investuese për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në vendbanimet që nuk kanë trajtim adekuat, duke i dhënë përparësi aglomerateve me mbi 2 mijë banorë për instalimin e impianteve funksionale.*

e) *Të zhvillohen fushata vetëdijesimi dhe edukimi për qytetarët, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e ujërave, përdorimin e qëndrueshëm të tyre dhe ndalimin e ndotjes.*

f) *Të bashkëpunojnë me KRU-të dhe autoritetet e tjera kompetente për përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe për ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjet, me qëllim sigurimin e furnizimit të pandërprerë dhe cilësor me ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët.*

g) *Në bashkëpunim me autoritetet relevante, të evidentojnë të gjitha sistemet rurale të furnizimit me ujë që funksionojnë jashtë menaxhimit të operatorëve të licencuar dhe të ndërmarrin masa për integrimin e tyre nën monitorim të rregullt të cilësisë së ujit, nën menaxhimin e ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.*") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit